ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE & KULTURORE

Themelues BUJAR HUDHRI
Kryeredaktore VIOLETA MURATI

E SHTUNË, 23 MARS 2019. NUMËR 19. VITI I I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Një bisedë me shkrimtarin Agron Tufa është gjithnjë shumëdimensionale, janë angazhimet dhe ritmi i jetës së tij, që e diktojnë këtë: shkruan prozë, poezi, përkthen me po aq intensitet sa ç'përpiqet të krijojë një mundësi komunikimi mes lexuesit dhe autorëve të tjerë, sidomos bashkëkohorë, të gjeneratës të tij. Është ndër shkrimtarët e parë të pas '90-s i cili theu kanonet skematike të realizmit socialist, që e vazhdoi letërsinë si vokacion e ndërgjegje intelektuale, bashkë me detyrat "politike" në zbardhjen e krimeve të komunizmit..

Skicë nga Bujar Kapllani

AGRON TUFA

LETËRSIA E MIRË FSHEH NJË APEL, QË TA PËSHPËRIT, SI NJË URDHËR I BRENDSHËM

OPINION

TË KËRKOSH GJURMËT E NJË REBELEJE NË BERLIN

Nga Ana Kove (fq. 12)

KUR PËRKTHEJA KADARENË

Nga Mira Meksi

ESE



FREDERIK RRESHPJA INTENSAT SHKRIMORE DHE LIRIKU I RRALLË I LETRAVE SHQIPE

Nga Behar Gjoka (Fq. 10)

Letërsia shqipe në panairin e librit në Leipzig (Fq. 7)

Koço Qendro, empatia e Harpagonit 92 vjeçar (Fq. 7)

Mircea Eliade, "Miti dhe realiteti" në shqip (Fq. 7)



LINDITË AHMETI
ISHULLI ADULAR

EUGÈNE IONESCO

TRAGJEDIA E LIGJËRIMIT

(Fq. 14)



BIBLIOTEKË

AT JUSTIN RROTA
BUZUKUN LYPNI?



Një bisedë me shkrimtarin Agron Tufa është gjithnjë shumëdimensionale, janë angazhimet dhe ritmi i jetës së tij, që e diktojnë këtë: shkruan prozë, poezi, përkthen me po aq intensitet sa ç'përpiqet të krijojë një mundësi komunikimi mes lexuesit dhe autorëve të tjerë, sidomos bashkëkohorë, të gjeneratës të tij. Është ndër shkrimtarët e parë të pas '90-s i cili theu kanonet skematike të realizmit socialist, që e vazhdoi letërsinë si vokacion e ndërgjegje intelektuale, bashkë me detyrat "politike" në zbardhjen e krimeve të komunizmit, në krye të Insitutit të Studimeve të pasojave dhe krimeve komuniste, reflektuar në botimet që dëshmojnë e rrëfejnë diktaturën 45 vjeçare

AGRON TUFA
LETËRSIA E MIRË FSHEH NJË APEL, QË TA PËSHPËRIT, SI NJË URDHËR I BRENDSHËM

Intervistoi: Violeta Murati

Ndonjëherë ia vlen të niset nga e para, ku kujtesa mban ngjarjet më të rëndësishme të jetës, e në rastin tuaj atë të shkrimtarit: cilat kanë qenë kujtimet tuaja me të para ala prustiane?

Agron Tufa: Ndoshta ka vlerë për gjithkënd vargu i T.S. Eliot në poemën "Katër kuartetet": "Në fillimin tim është fundi im" (dhe anasjelltas). Në rastin tim nuk mendoj se ka ndonjë gjë të pazakontë. Fëmijëria, adoleshenca dhe rinia e parë kaloi në një nga provincat me të humbura verilindore të Shqipërisë, treva e Kastriotit të Dibrës, në një familje krejt të zakonshme fshati. Me vëllezër e motra, nënë, gjysh e gjyshe. Kozmosit shtëpiak i mungonte një njeri i rëndësishëm, që përmendej shpesh nga të rriturit, por nuk ishte i pranishëm fiziksht: im atë. Me kohë u mësuam, derisa ai u kthye nga burgu politik i Spaçit, kur unë isha 9 apo 10 vjeç. Në kujtesën time kanë mbetur perceptimet dhe qëndrimet e ndryshme që mbanin njerëzit jashtë shtëpisë ndaj nesh dhe familjarët brenda shtëpisë. Jashtë, me kohë, kemi dëgjuar të na thërrasin (ndër to edhe ndonjë mësues) "reaksionar", "bir i armikut të partisë e të popullit", ndërsa brenda, sidomos gjyshja, sa herë qortonte, tundte gishtin e bënte apel: "dhe kurrë, kur mos harro, bir i kujt je!" Jashtë, në rrugë, në shkollë, na shihnin "ndryshe", aq sa një ditë të zakonshme shkolle të klasës së parë e kuptova shkakun, kur një bashkëmoshatare, e nxehur me mua shpalli, duke bërë një gjest dëbues me dorë: "iiiii, ik, ik, ik! Ju jeni 'të prekur'!". U trondita. Nuk e kuptoja se ç'kuptim kishin ato fjalë, ndaj sapo hapa derën e madhe të oborrit i thashë tim vëllai më të madh se unë: "Ylber, pse na quajnë ne 'të prekur'? A na ka prekur kush me duar me pis?". "Jo mor budallë, - ma preu ai, - na quajnë kështu për shkak se baba jonë është në burg". "Po pse është në burg? Çfarë ka bërë?", - këmbëngula ta di. Im vëlla, që vazhdimisht gjuante një top llastiku duke e përplasur pas mureve të shtëpisë, mezi m'u përgjigj shkurt e thatë: "sepse ka qenë kundra!". Unë doja të di diçka më shumë se kaq, dhe e pyesja vazhdimisht të dija: "si ka qenë kundra?". Im vëlla vazhdoi të gjuante më me tërbim topin pas mureve, por kur pa se nuk i shqitesha, i la gjuajtjet dhe m'u kthye: "Ka folur kundra pra, bashkë me disa shokë... me ata shokë, sa herë inatoseshin me shtetin, mblidheshin fshehtas dhe flisnin kundra". "Po si e dinin ata se duhet të flisnin kundra?", - ka qenë pyetja ime e fundit. Por im vëlla, me sa dukej ishte shumë më i ndriçuar se unë, sepse m'u përgjigj: "Ata kishin një parrullë. I afroheshin njëri-tjetrit te puna dhe i thoshin të veshi: xhundra-bullundra, a flasim kundra?". Kjo përgjigje më bëri edhe më shumë konfuz, dhe nuk guxova ta pyes më; im vëlla i ishte kthyer gjuajtjeve të topit për mur me një furi të re.

Gjithmonë, jo se e kam vuajtur, por e kam ndjerë se, në lidhje me tim atë, kujtesa ime fillon pas ardhjes së tij nga burgu, kur unë isha relativisht i rritur. Ndjeja boshllëkun e peridhës para arrestimit. Motra dhe dy vëllezërit më të mëdhenj e mbanin mend, unë jo. Unë nuk i kisha mbushë tre vjeç, ndërsa vëllau i vogël, ferrishte në djep, s'kishte asfarë shansi ta mbante mend. Kështu e kisha lënë... por kujtesa ka kapriçot e veta. Sesi një ditë, në një nga qindra pasditet e shëtitjeve të mia, pas mësimit, në Institutin e Letërsisë "A.M. Gorki", ndërsa endesha nëpër rrugët e Moskës, filloi të më vizatohej në kokë një si tablo, e gjitha nën ndikimin e të kënduarit nën vete të një kënge të vjetër. Sa më fort merrja e rimerrja melodinë dhe fjalët e këngës, aq më e qartë bëhej tabloja, e mandej nisi edhe të lëvizë, si një kuadër i stërvjetëruar filmi. Kur dola në krye të rrugës ku hapej sheshi "Patriarshie prudi" (Gjolet e Patriarkut), hyra në barin e parë me pamjen që shihte në një pistë akulli ku luhej hokej. Ishte diçka fare pa lidhje pamja që kisha përballë, përtej xhamave, disi të avulluar, dhe tablosë që kishte ndaluar në kokën time. Sërish motivi i këngës dhe tabloja e marrtë nisi të kjarohej, madje të lëvizte. Një gjysmërreth burrash me kësula, të ulur këmbëkryq në sofër, ndanë zjarrit të oxhakut, kokat e të cilëve projektoheshin në murin kundruall nën dritën e butë të dy llampave me vajguri, ndërsa në anën tjetër të sofrës, përballë burrave, qëndron tek, një burrë tjetër, me kësulë e mustaqe të holla spic. E njoh: ai është im atë. I bie çiftelisë dhe këndon për njëfarë Mahmud Daci. Është pikërisht kënga që këndoja nën vete atë pasdite shëtitjeje dimërore. Një këngë trimërie, pabesie dhe amaneti. Ndërkohë që i bie çiftelisë dhe këndon, ka në fytyrë një shqetësim, një bezdi, ngase fëmija që vrapon rrotull nëpër dhomë po ia prish solemnitetin e këngës, duke lëshuar gjithë e më fort britma të forta: "E Daci, more Daci! Daci bre, Daci!", - i çuditur, me gjasë, se si mund t'i këndohej me aq përkushtim një maçoku, sikundër quhej maçoku në dialekt. Im atë ka rrudhur vetullat vertikalisht mbi hundë dhe kërkon me vështrim ta parandalojë fëmijën, t'i kanoset, por kalamani rrotullohet e bërtet, derisa i afrohet te vegla muzikore dhe ia kap. Atëherë i ati e zë për veshi, ia tërheq fort dhe e shtyn, duke i bërtitur: "përjashtë, edepsëz! Hyn në dhomë e ëma dhe e heq djalin prej andej.

"Kur ka ndodhur kjo?" – pyesja veten, - dhe "a është e vërtetë?" E fiksova përshkrimin e kësaj ndërmendjeje në letër, por nuk isha i sigurtë. Mos ndoshta është ndonjë kujtim i simuluar, një nga ato kujtime "mashtruese", një rreng i kujtesës nën ndikimin e ndonjë ëndrre? Por kisha nga ana tjetër një siguri, që ma jepte pamja e tim eti, instrumenti, vetullat e mbledhura vertikalisht. Kur ktheva për pushimet e verës e pyeta tim atë, sa i vërtetë është ky kujtim. Ai qeshi: "është krejt i vërtetë, nuk është rrenë. Burrat me kësula janë Allamanët e Matit, që kanë pasë ardhë miq, me rastin e hymjes në shpinë e re. Janë ata, me të cilët jam dënuar mandej në të njëjtin proces politik. Këngën e këndova pas darkës në shenjë nderimi, ndërsa llampat kanë qenë me vajguri, sepse ende nuk ishin kryer instalimet elektrike. Edhe veshin ta tërhoqa se ma prishe qejfin e këngës së Mahmud Dacit". U ndjeva shumë mirë. Kisha mundur të riktheja një kujtim, para se baba im të arrestohej. Kisha zgjeruar mbretërinë time të kujtesës, duke e bërë atë të pavdekshme. Dhe dihet se kujtesa është e vetmja që lidh skajet e identitetit të njeriut. Këtë gëzim e ngazëllim ndjejnë dhe personazhet e Marsel Prustit, kur i luftojnë Harrimit copëza të vogla nga përjetësia e kujtimeve.

Si ka nisur ideja, shkrimi, botimi i parë...? Si e zbuluat zërit tënd?

A.T: Kam qenë një lexues i magjepsur nga librat. Leximin e kam nisur nën ndikimin e vëllait të madh. Ai lexonte libra të trashë, kur unë ende nuk dija të lexoj, por kur e shihja të veçuar, të shtrirë përmbys tek lëvrinte në heshtje buzët, i përpirë nga ato mistere të veshura me shkronja, e ndjeja veten të privuar rëndë. Im vëlla më tregonte ndonjë histori dhe unë ua tregoja moshatarëve të mi, duke i zbukuruar shumë ato. Pastaj vetë, shumë shpejt, krijova një varësi të tmerrshme nga leximi. Një varësi e cila krahasohet me atë të duhanxhiut, alkoolistit apo të narkomanit. Kjo ishte ana e keqe, sepse në shtëpinë tonë të varfër, nuk kishte libra. Kështu, që për t'i siguruar ato, kam ndërmarrë një sërë aksionesh: grumbulloja shishe të boshatisura vaji, i laja me ujë të nxehtë me një shkop që kishte në majë një shtupë lecke me sapun dhe pasi i shisja, blija libra në Peshkopi, e më vonë në Kastriot. Një burim tjetër ishin vezët, që i mblidhja të shtëpisë, apo nëpër plevicat e lagjes. Sepse pula ta bën me dije kur lëshon vezën... Pastaj ka pasur burime të tjera: bimët mjekësore, grumbullimi i lekëve të dhuruara, shokët, më të rrallë në bibliotekën e shkollës, dhe kur nuk më kanë dhënë as në bibliootekë, edhe i kam vjedhur, duke qenë i ndërgjegjshëm se kjo aventurë është e dënueshme. Ëndrrat e mia të fëmijërisë, që kanë vazhduar gjatë (e ndonjëherë më shtiren dhe sot), janë parajsa bibliotekash të larmishme. Shkurt, një njeri që ka varësi të tillë nga leximi, heret a vonë do të shkruajë. Nuk kisha vendosur të bëhesha shkrimtar, por një ditë

(duhet të kem qenë në klasën e gjashtë), më doli krejt papritur e solemnisht pohimi. - A ke menduar se çfarë do të bëhesh në jetë mor djalë? – më foli i pezmatuar im atë një pasditeje, kur pa se nuk e kisha fare mendjen në zejen që po më mësonte. Asokohe im atë mendonte t'i mësonte zanatin e marangozit, të paktën njërit prej nesh. Na e kishte thënë shpesh: "Ju shkollë nuk ju japin. Të paktën mësoni zanatin, se do të kalbeni në punët pa bereqet të kooperativës. Nuk do t'ju hiqen nga duart kazma e lopata dhe nuk do të bëni dy jaka bashkë". Nuk e di pse ma kishte vënë mua syrin si "marangoz i ardhshëm". Tash më vjen keq njëmend që nuk e dëgjova. Në Shqipëri, më besoni, është shumë herë më mirë të jesh marangoz, se shkrimtar. Po ja, qe e humba këtë mundësi të artë... Pra, atë pasdite kur im atë më pyeti se "çfarë e ke ndërmend të bëhesh", i përqendruar në një radiodramatizim të romanit "Djaloshi zezak" të Riçard Rajt, pa e pritur as vetë, thashë: "shkrimtar!". Ka shumë gjasë që përgjigja ime të ketë qenë një nga replikat e ndonjë personazhi, por këtë më duhet ta verifikoj. Megjithatë, pasi e thashë, vërtet mendova se s'ka gjë më të bukur se të bëhesh shkrimtar. Si nuk më paska shkuar ndërmend më parë?

- Si the, si the... ? – pyeti prapë im atë, që tashmë kishte lënë zdrukthin dhe më shihte i habitur, me duar në mes.

- Shkrimtar do bëhem... ke për ta parë, - thashë, sikur të ishte ky një kërcënim.

Nuk po e kuptoja. Im atë filloi të qeshë graflueshëm, në fillim pa zë, pastaj shpërtheu në një të qeshur, që nuk mu duk normale për atë, që qeshtë rrallë.

- Çfarë ka, - thashë. Por ai vazhdoi të qeshte. Ndalej e vazhdonte sërish.

- Shkrimtar! Posi... shkrimtar, zotnija jote! Shkrimtar si Gjergj Fishta?

Unë ngrita supet. Tani nuk qeshte më.

- A e di ti ku e kanë vendin shkrimtarët?

- Në libra... – thashë, i pasigurtë.

- Jo në libra! Ta them unë se ku, - tha, duke m'u avitur misteriozisht, me gishtin tregues ndër buzë: në burg! Kam pasur plot atje... shkrimtarë... Ishte njëri, i katandisur, vesveseli. Sapo i afrohej ndonjëri, bërtiste: "Iiiik! largohu! Të ka sjellë Sigurimi i shtetit!" Dhe askush nuk i afrohej. Tani më thuaj, çfarë shkrimtari do bëhesh? Se ka dy rrugë për shkrimtarët: o do të shkosh në burg, o do t'i këndosh Partisë. Ti në burg nuk do të shkosh, kështu?

- Jo, nuk është ndonjë qejf i madh nga sa na ke treguar vetë...

- Atëherë do t'i këndosh Partisë... S'ke rrugë tjetër!

- Po mirë, e pastaj? – thashë i revoltuar.

- Pastaj!? Ti mund t'i këndosh Partisë, po a të zë besë kush...? Ta them unë, askush! Dhe kur nuk të besojnë, prapë në burg do përfundosh...

- Nuk e di.. Nuk e di, - mërmërita, - por unë do bëhem shkrimtar dhe pikë!

- Mirë, de mirë... ashtu e lëmë... po atë pikën, hiqe.

Unë kam shkruar, si shumë kush, në shkollën e mesme, nën ndikimin e rasteve, miqve të mi të ngushtë dhe nga ideja se mund të shkruaj më mirë nga sa botohej asokohe në shtypin letrar. Miqtë e mi, që gjithashtu ishin në fillimet e tyre, kanë qenë mbështetje e madhe. Sidomos miqësia me shkrimtarin Ramiz Gjini.

Në gazetën lokale të Dibrës nuk të botonin për arsye biografie, por botimet e vargjeve të para i kam pasur në gazetën lokale "Jeta e Re" të Shkodrës, ku redaktor i faqes letrare ka qenë shkrimtari Ridvan Dibra, me të cilin asokohe nuk njiheshim. Në shtator 1989 dhe 1990 kam botuar cikle të gjera poezish tek gazeta "Zëri i Rinisë", mandej dhe tek "Drita". Nuk mendoj se do të kisha botuar ndonjëherë në "shtypin qendror", pa ndihmën shumë dashamirëse e vendimtare të dy poetëve: Ilirian Zhupa dhe Preç Zogaj.

Mendoj se çështja e "zërit tënd", diksionit, nuk zbulohet menjëherë, sepse ai është një proces i vazhdueshëm, si i rritjes kulturore, aq dhe i përvojës me "zbutjen" e bishës së shkrimit. Sepse shkrimi është një bishëz e egër dhe ti duhet t'i avitesh me ëmbëlsinë e zbutësit, nëse do të të shërbeje me bindje e besnikëri.

-Të ikim pak në kohë, pse keni zgjedhur të jetoni këtu? Në Shqipëri, në Tiranë…e rrallë po të shohësh se si në këto 30 vite liri të gjithë (pothuaj shkrimtarët e artistët) jetojnë në kryeqytet, kanë braktisur qytetet e lindjes.

A.T: Nuk është çështje zgjedhjeje. Është çështje infrastrukture: puna, mundësitë, kushtëzimi pastaj, pas krijimit të familjes, etj. Në fund të ciklit 7 vjeçar të studimeve të mia në Rusi (1994-2001), kisha mundësitë të mos kthehesha në Shqipëri. Kisha një vend pedagogu në katedrën e Europës Juglindore ku jepej gjuhë, folklor e letërsi shqipe në Institutin e Mardhënieve Ndërkombëtare (MGIMO, Moskë). U ktheva në atdhe, si shumëkush tjetër, besoj, i ngarkuar me ëndrra, besim e shpresa për të dhënë më të mirën që mendoja se di të bëj. Kjo ka ndodhur gjithmonë, që nga fillimi i shekullit XX, deri në fund të Luftës së Dytë Botërore: intelektuali që kthehet të shërbejë natyrshëm në vendin e vet. Se, ç'kuptim ka? Pse e more gjithë atë shkollim? Ndjej se dhe unë i përkas një kategorie të tillë. Do duket pak si patetike, por nuk di si ta formuloj ndryshe, përveçse kështu: nuk është se na tradhëtuan ëndrrat, na tradhëtoi realiteti. Realiteti shqiptar është një gjë e tmerrshme, e pistë, mosmirënjohëse. Edhe pas kaq vitesh, shohim se nuk shterr së gurgulluari jashtë e keqja. Do thoja, një realitet i "zgavruar". Dhe çdo zgavër është e mbushur me helm, të depozituar ndër breza, kohëra e tradita. Nuk është pra, se na kanë tradhëtuar ëndrrat. Janë po ata. Dhe unë po ai: realiteti shqiptar do sforcim e përpjekje të madhe të ndryshojë, do aleancë njerëzish të dituar e idealistë. Do solidaritet. Dhe ndonëse jetojmë në një nga fazat më dëshpëruese, që nga koha e diktaturës, edhe pse shumica e shqiptarëve ka ikur e në mendje ka të ikë, prapë mendoj se ky vend do të ndryshojë për mirë, për të kapur ritmin e vet të natyrshëm, pavarësisht gjithë katalogut rekord të veseve e skrupujve politike, historikë e shoqërorë. Dhe besoj se ka shumë shqiptarë që mendojnë se ky vend mund e duhet të mbërrijë përputhjen e nivelit të natyrës dhe klimës që ka me nivelin e ndërgjegjes njerëzore. Ideale, sigurisht, do të ishte të jetoje në vendlindje. Atë e kam shtyrë si projekt, ndoshta për të kaluar pleqërinë.

Çfarë ka mbetur nga Dibra jote, vendlindja?

A.T: Thuajse asgjë. Por kurrë nuk kam thënë se Dibra ime ishte një vend ideal. As i mirë, as i keq. Ishte një vend vuajtje. Një trekëndësh Bermude i komunizmit shqiptar. Sigurisht është tjetër të flasësh për traditën, virtytet, zgjuarsinë, me të cilën Dibra ka krijuar një identitet të veçantë, por mos harrojmë: ishte një realitet persekutues. Me plot njerëz të ligj, përndjekës, që më mësuan të njoh, para së gjithash, mungesën e zemërgjerësisë, vogëlsitë, fanatizmin absurd politik, servilizmin, pabesinë, në një kohë kur varfëria ishte shokuese, kushtet e jetës tepër të rënda dhe shpresat nuk ekzistonin në horizont. Dibra ishte një vend skllav, e tëra bujkrobëri komuniste me feudalët e kuq lokalë. Tani ekziston një Dibër tjetër, e përçudnuar si më parë nga varfëria dhe emigrimi. Nuk vuan për mbijetesë ushqimore, por nga lumpenizimi, papunësia, varfëria, mungesa e perspektivës. Me se e mbajnë veten gjallë

ato banorë? Me çfarë shpresash? Dibra është një vend i izoluar, si më parë. I pasur në prodhime e burime, por krejt pa mundësi t'i konvertojë ato në mirëqenie. Një popull i keqpërdorur nga politikanë lokalë e qëndrorë, të cilët i shëmbëllejnë një bande fantazmagorike: është krijuar një marrëdhënie shitje-blerje midis popullit dhe politikanëve, çka ka çuar në një alienim ekstrem të njerëzisë, e cila përpiqet të mbijetojë...

Ju njiheni si një ndër përfaqësuesit e avangardës së viteve '90 në Shqipëri, që patët për mision shkatërrimin e sintaksës dhe kanoneve skematike të socrealizmit. Grupimi e kreu misionin, po me shkrimtarët çfarë ka ndodhur, jeta e tyre letrare nisur aq stuhishëm...

A.T: Grupimi i parë letrar në Shqipëri, i organizuar si shoqatë poetësh me titullin "E për-7-shme", me një gazetë jetëshkurtër me të njëjtin emër, u përftua vetvetiu nga botimet e cikleve poetike në vitin e fundit të diktaturës 1989-1990. Ishin ndër më të talentuarit. Fati e deshi që vetvetiu u mblodhën në Fakultetin Filologjik të Tiranës, ndër të cilët kanë qenë dy Rudat (Zekthi dhe Erebara), Mark Marku, Ervin Hatibi, Eneida Topi, i ndjeri Ilir Belliu, Pëllumb Zekthi dhe Dritan Xhelo. Në kohën kur shoqata jonë thurte plane, po dilnin parti të ndryshme politike dhe një natë, bashkë me Mark Markun, Rud Zekthin e Ilir Belliun, u fol seriozisht për krijimin e një partie politike, të cilës do t'ia vinim emrin "*Partia e shkatërrimit të strukturave gjuhësore*". Ideja e themelimit të një *gjuhe të re* na tërhiqte vazhdimisht. Them u fol "seriozisht", sepse asokohe nuk ia varnim shumë, ku fillonte e ku mbaronte serioziteti. Po në këtë kohë nuk ishin vetëm këto emra. Kishte një orbitë të talentuarish bashkëmoshatarë, që kishin shumë karakteristika të afërta shkrimi, siç e gjykoj unë sot. Mbresë të thellë më kanë lënë asokohe poezitë e Luljeta Lleshanakut, Lindita Arapit, Virion Graçit, Alban Balës, Florion Hidës, Gent Gjokolës, Arian Lekës e më vonë, të Parid Teferiçit, Gentian Çoçolit, Romeo Çollakut, Ledia Dushit, Olimbi Velajt, etj., të cilët i kam konsideruar si e njëjta frymë në variacione të ndryshme. Është e vërtetë, që metaforat, gjetjet figurative, idetë e ndjeshmëria, vetë koncepti poetik dhe sidomos sintaksa e vargut, dallohej radikalisht nga traditat e mëparshme të poezisë shqipe. Pra është më mirë të flasim për një gjeneratë të '90-s, se sa për një grupim poetësh. Grupimi letrar në fillim të krijimtarisë është një gjë jashtëzakonisht nxitëse, por me kalimin e kohës ai ka efektet e veta negative, që çojnë në influencimin e ndërsjelltë të njëri-tjetrit. Por unë u largova i pari, me 1994 me studime në Moskë dhe, me kohë, atje, zbuta marrëdhëniat e mia të acaruara me format klasike të poezisë, muzikalitetin, ritmin, rimën etj.

Mendoj se, të gjithë këta poetë kishin një alergji të theksuar nga gjuha dhe klishetë e realizmit socialist. Në letërsi po vinte një tip i ri artisti, me një gjuhë e vetëdije tjetër, me një uri kulturore dhe me një theks të spikatur metafizik. Kjo ishte avangarda, ndonëse askush nuk ishte koshient për termin. Kohëzgjatja e saj, nga viti 1990 deri me 1994 është korniza kohore klasike e këtij grupimi. Ndërkohë disa prej këtij brezi të viteve '90, filluan të botojnë librat e parë poetikë: Rudian Zekthi "poezi" (1990) Ervin Hatibi "Përditë shoh qiellin" (1990); Ilir Belliu "Vetmi me njerëz" (1992); Lindita Arapi "Kufomë lulesh" (1992); Virion Graçi "San Valentino" dhe romanin "Të çmendur në parajsë" (1993); Luljeta Llshanaku "Sytë e somnambulës" (1993) dhe "Kambana e së dielës" (1994). Shumë nga këta emra janë sot poetë e prozatorë të konsoliduar me nga 10-15 vepra. Të tjerë, disa të paktë kanë zgjedhur heshtjen. Gjë krejt normale.

Kujtoj publikimin e antologjisë emblematike të nëntë autorëve të grupimit, me titullin "O moj Shqypni dhe të tjera lirika", në një dyvjeçar '93 –'94 të njëjtët poetë u mblodhët rreth revistës "Zëri i rinisë"...

A.T: E para antologji e grupimit "*O moj Shqypni dhe lirika të tjera*" u shtyp në nëntor 1991 në Elbasan. Një broshurë e hollë me 63 poezi të nëntë poetëve me nga shtatë poezi secili. Natën, kur dy thasë me këtë antologji erdhën në konvikt, godina 21, qe festë, por që zgjati shumë shkurt. Të nesërmen thesi i mbetur, u vodh. Kështu që mbetëm pa të. Mua më ka mbetur një ekzemplar. Mendoj jam ndër fare të paktët që e kam. Shoqata jonë "E përshtatshme" nxorri dhe një gazetë letrare me këtë emër, një lloj surrealizmi a dadaizmi mund ta quash drejtimin, stilin e konceptimin të saj, por që, ne, as nuk ia kishim idenë asokohe, sepse nuk i njihnim këto shkolla të avangardës. Kishim një zyrë të shoqatës ku kishim një sasi markash gjermane. Këto i vodhi një sekretar i shoqatës (një tip që s'po ia përmend emrin, i cili nuk botoi kurrë më poezi) dhe me këto para u arratis në Hollandë për të vazhduar studimet, të cilat, dhe ato nuk i mbaroi. Thonë u mor me tregëti a dallavere të tjera. Nga viti 1993 deri në qershor 1994 thuajse të njëjtat pena u mblodhëm tek "Zëri i Rinisë" (ndjesë pastë kjo gazetë!). Asokohe punoja vetëm unë tek "Zëri". Me ardhjen e M. Markut si Drejtor administrativ, gazeta konsiderohej e lirë për botimin e secilit nga grupi. Atë vit unë drejtoja suplementin letrar të "Kontrapunkt" të "Zërit të Rinisë", një suplement me 8 faqe format i madh, e mandej me 16.

Nga një poezi e fundit e juaja, me nënshkrimin Prishtinë, 2018 ndajmë vargjet: Koha e mahnisë mbaroi.../dhe flaka që digjet, nuk djeg... Reflektimi? Po mendojmë mbi disa procese, ide e vlera që vijnë bashkë me kulturën masive, modernitetin...

A.T: Similituda që e mban këtë poezi është shumë e ndërlikuar dhe unë jam i pafuqishëm të shpik një gjuhë tjetër, që të mund të rivalizonte vetë poezinë. Referencat dhe asociacionet janë nga shkurrja e famshme biblike që digjet, e s'mbaron së djeguri, e cila i shfaqet profetit Moisi në kullotë. Pra është një zjarr që flakëron, por nuk i djeg degët e shkurres. Ajo është një formë e shfaqjes së Zotit dhe Moisiu grishet përmes asaj flake të çuditshme të avitet për të hyrë në lidhje me Hyjin. Poezia ime shenjon procesin e desakralizimit total, e zbrazjes së shenjave nga kuptimet e tyre, e zhvlerësimit dhe inflacionit të fjalës si taksonomi ligjërimi, e alienimit gazmor e argëtues të Babilonit të ri bashkëkohor, rrjedhimisht, dhe e blasfemive të reja.

A mund të flitet, sidomos nga një shkrimtar si ju, se në cilën fazë të krijimtarisë e vendos veten?

A.T: Mendoj se po. Por fazat nuk zgjasin me vite. Mendoj se është diçka tjetër dhe kjo është fryma e një radhe veprash, në të cilën ke përmbushur disa ideale artistike e estetike. Unë e konsideroj veten në prag të një faze të dytë tashmë, me idenë se ka, në dashtë Zoti, një fazë të tretë, të fundit.

Është një punë voluminoze dhe impenjative çfarë keni bërë me monografinë "Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX", ku po përgatiteni edhe për dy volume të tjera. Kur institucionet përgjegjëse ende nuk kanë nisur procesin e shkrimit të historisë letrare, pse një nisme e juaja, çfarë varianti parashtron ky botim?

A.T: Po, por kjo është një punë e drejtpërdrejtë, shumëvjeçare, me auditorin e Letërsisë në Fakultetin Filologjik të Tiranës. Janë leksione të përgatitura ngadalë, ngeshëm, përgjatë 15 vjetësh, jo në stilin e thatë të leksioneve pedante. Përgatitja e çdo leksioni përfundimtar ka hëngër mesatarisht nga 6 muaj lexime e shënime intensive rreth një autori. Ideja ka qenë që të kishte një tekst me tre vëllime për ta njohur letërsinë e huaj të shek. XX në frymën e saj, në proces e rrjedhë, nga zanafilla e modernizmit (simbolizmi), e avangadës dhe postmodernizmit. Tre paradigma artistike, që përfshijnë krejt shekullin XX. Vëllimi i tretë do të jetë antologji me manifeste, traktate, fragmente poemash, novelash, tregime, poezi, drama – si një pasqyrë e shkrimtarëve dhe poetëve nga letërsitë e ndryshme moderne të kulturave kombëtare të Europës dhe Amerikës e më gjerë. Kam menduar se me këtë projekt plotësohet një boshllëk tradicional për këtë lëndë, e cila në vitet e diktaturës reduktohej nga 2 deri në 4 autorë (Gorki, Majakovski, më vonë dhe Fadajev, Furmanov), të gjithë të socrealizmit sovjet. Në vitet '80-të u shtuan dhe Bertold Brehti e Hajnrih Bëli. Sigurisht, gjatë viteve '70 – '80 ka pasur leksione speciale dhe kurse për letërsinë "dekadente borgjeze", është folur dhe për Xhojsin, Kafkën, Prustin, Kamynë e Sartrin, por si, për demonë e përbindësha. Ideja ime ka qenë që, me shqyrtimin e krijimtarisë së mbi 20 autorëve (modernistë, avanguardistëm, postmodernistë), ta vë studentin shqiptar në të njëjtat pozita komode, sikur ai të ishte natyrshëm, në çdocilin auditor të universiteteve të Romës, Berlinit, Parisit apo Nju-Jorkut. Por qëllimi i këtij projekti me tre vëllime, që shkon mbi 1000 faqe, shtrihet dhe përtej auditorit të studentëve, ngase synon një lexim të gjerë, intelektual, për gjithkënd që interesohet për letërsinë moderne të shekullit XX.

Kam përshtypjen se rrëfimi i "sagave" familjare nën trysninë e diktaturës ka kaluar tek ne nëpër një proces të shumëllojshëm shkrimi. Mbaj parasysh tri romanet tuaja si "Mërkuna e zezë", "Tenxherja" mbyllur me "Thembra e akcilit" që përballet me mitin urban, mbetjet nga totalitarizmi, njerëz me delire e paranoja. Larje hesapesh e keni quajtur, por pse kjo sagë?

A.T: Jo gjithmonë. Katër romane të mi "Dueli", "Fabula rasa", "Tenxherja" dhe "Gurit të varrit ia rrëfej" janë romane të shkruar me regjistra stilstikë krejt të ndryshëm. Ajo që kanë të përbashkët janë realet e kushtëzuara të diktaturës. Protagonistët janë përherë në kërkim të personalitetit të tyre në përditshmërinë totalitare. Shumica janë në kapërcyellin e adoleshencës dhe e ndjejnë se personaliteti i tyre kërcënohet nga makina shtypëse: para tyre zbulohet tërë lemeri njëfarë farë fuqie e errët, e epërme, që merr trajta satanike. Dhe si e tillë përjetohet. Ajo fuqi zhduk fshin, rrafshon, nivelon, deri në tjetërsim e shpërfytyrim këndet e personalitetit, siç ndodh me shumë prej tyre që rebelohen dhe kërkojnë të mbrojnë të pakompromentueshëm thelbin e tyre të brendshëm. Këto romane përbëjnë sagën e pjekjes në ag të burrërimit dhe ankthin se diç e keqe, e pabesë do të ndodhë me ta. Është një frikë që dhe i irriton, dhe i rebelon; një frikë e ngjashme si ankthi prej kastrimit. Ndërsa romani "Tenxherja" po, është një sagë familjare dhe është shkruar si larje hesapesh me shumë reminishenca që vinin prej së kaluarës. Ai ka mjaft nota biografike. Është shkruar vetëm për të hequr qafe një ëndërr të ankthshme, që përsëritej thuajse e njëjtë ndër vite, sikur donte të më shoqëronte për gjithë jetën. Këtë quaj "larje hesapesh". "Mërkuna e zezë", është një roman që s'ka lidhje më me realitetet komuniste, por me fanatizmat dhe frymën autoritare të sektit, cilado qofshin sektet fanatike, fetare, femërore, mashkullore, politike etj.

Gjatë një gjysmë shekulli diktaturë shkrimtarët shqiptarë lanë pa përjetuar në veprat e tyre gjithë frymën tragjike të epokës, duke u modeluar tërësisht pas "romantikës" rozë, që diktonte dogma zyrtare. A nuk ju duket absurde kjo, të cilën duhet ta sqarojë historia e letërsisë sonë? Kush duhej t'i përjetonte, nëse shkrimtari jo?

A.T: Historia e letërsisë sonë më mirë të mos shkruhet njëherë. Sepse është e sigurtë që do të manipulohet, cilidoqoftë kriteri, qasja, metoda. Dhe atë nuk duhet ta shkruajnë duar të pista. Gjithsesi ai do ishte një tekst kryesisht me karakter shkollor/universitar. Një tekst akademik. Duart e përlyera rrinë gati ta bëjnë edhe këtë ndotje të fundit. Ja pse nuk më shqetëson mungesa e një Historie të Letërsisë. Ne kemi gati 30 vjet pas rënies së komunizmit dhe nuk është hartuar një antologji për poezinë apo prozën shqipe. Rënia e ideologjisë totalitare komuniste, nuk shërbeu dot

si një kufi i qartë i kriterit të lirisë artistike, që ndan dy epoka. Kihet dëshirë që gjërat edhe në letërsi të përlyhen, të përzihen, të llangosen e të zhyhen në emër të "vazhdimësisë", të "organicitetit". Sikur asgjë nuk ka ndodhur. Sikur çdo gjë vijon udhën e vet normale. Stop! Këto dokrra nuk i gëlltit më kush. Dhe kjo alibi, kjo apologji, bëhet për të legjitimuar socrealistët. Vërtet që periudhat letrare nuk kanë "dyer", që hapen e mbyllen prerazi, duke futur dikë brenda e duke lënë dikë jashtë, por kurrë, kurrësesi nuk mund të barabitësh si të njëllojtë një vetëdije krijuese që hyri e lirë në letërsi, me një vetëdije të cenzuruar e vetëcenzuruar në përshtatje me dogmën ideologjike, së cilës i është përshtatur dhe i ka dhënë haraçin. Prandaj e them prapë: mirë që nuk është shkruar një Histori e Letërsisë, se përsëri do të thirreshin kumbarët e kumbareshat, xhaxhot e byrazerët, nunat e ndrikullat që i prekin thuajse të gjitha punët, duke i ndotur ato. Le të presim them dhe nja 20 a 30 vjet të tjera... dhe le t'i bëjnë këto detyra të tjerë njerëz, të shpëlarë nga zgjyra e shijes, koniukturat, hatëret e tarafet. Ne e kemi humbur besimin. Dhe akoma më keq: kemi humbur respektin për punën e tjetrit. Dallojmë veç të zezën tek përpjekja e tjetrit. E nëse nuk ka të zezë, e nxijmë vetë më zi se kukudhi. Kam shkruar dhe më parë në lidhje me mungesën e përjetimit të realitetetit të vërtetë në Shqipëri për gjysëm shekulli. Pra, letërsie shqipe për gjysëm shekulli ka fshehur krimin dhe kufomat e krimit. Ka fshehur gjithçka, për t'i mbushur fletët e saj me hipokrizinë më të ndyrë të planetit. Idile socrealiste. Shtirje. Propagandë servile. Kjo bëri që të vdesë gjuha e natyrshme e shkrimtarit. Pak role episodike qëndrese pati dhe ndëshkimi për ta qe inkuizicionist. Nuk flasim për ndonjë përjashtim, që përforcon rregullin. Por kishte shkrimtarë shqiptarë jashtë Shqipëria, që nuk e luajtën rolin e palaços. Vepra e Camajt, për shembull, apo "Libri i burgut" i Arshi Pipës. E letërsia në kohë të zeza, kërkon kurajë, burrni, vetëdije flijimi, madje më shumë se çdo fushë tjetër. Por pikërisht kur Ora e letërsisë shqipe kërkonte burra për qëndresë, nga ata, që letërsisë nuk i kanë munguar në të gjitha vendet dhe kohët, letërsia shqipe pati burrecër. Ajo thjesht u zhburrnua. S'kam pse flas më qartë. Flasin tekstet e pambarim, librat, me të cilat sot mund të ngresh një piramidë gjigande turpi. Dhe pyetja që kam shtruar unë është: ç'ndodh me "kodin gjenetik" të një letërsie kombëtare që ka gënjyer, mashtruar, falsifikuar, fshehur, që ka bërë palaçon, kur duhet të merrte kujën, ç'ndodh pra me genet, me ADN-në e saj, kur ka folur vetëm me gjuhën e gënjeshtrës? A do t'i vuajë vallë gjatë pasojat? Dhe cilat janë ato? Jo vetëm letërsia e ka këtë problem mospërjetimi të turpshëm gjysëmshekullor, por edhe artet e tjera. Nuk po flasim për atë epidemi kolerike që quhet film artistik shqiptar i Kinostudios "Shqipëria e Re", dhe këtë fytyrë turpi e gjeni non stop nëpër kanalet tona sot, me një mbrojtje të veçantë shtetërore. Po për këtë kam folur, sa jam ngjirur.

Flitet ndër shkrimtarë për natyrën pothuaj autobiografike të romanit, ashtu siç ju jeni shprehur: "Ndërsa romani im – jam unë. Cilat janë të vërtetat e tua, që nuk u përkasin gjesteve të jashtme?

A.T: Ka shumë teori mbi dobinë apo dëmin e madh të "autobiografizmit" në roman. Kur them "romani im – jam unë", kam parasysh atë çfarë kanë thënë mjeshtrit klasikë të romanit, Tolstoi dhe Floberi, në lidhje me heroinat e romaneve të tyre, Kareninë dhe Bovarinë. Po, romani është tejmase biografik edhe kur përshkruan një qenie imagjinare që nuk ekziston në të vërtetë, edhe kur ndërtohet si monolog i ndonjë sendi, ngjyre apo peme. Ky "biografizëm" është i pashmangshëm, përderisa jemi qenie antropomorfe, por nuk mund të bëhet çelës, madje çelës i vetëm shpjegimi e kuptimi për veprën. Kam bindjen se letërsia e mirë duhet të ushqehet nga imagjinata. Trilli artistik modelon një botë të vërtetash artistike, ndërsa biografizmi e ul vlerën letrare të veprës. I jep vlerë reportazhi apo fejtoni artistik. Gjyqi për një roman nuk shtrohet nëse ka gënjyer autori, nëse i ka mbetur besnik një realiteti të caktuar. Këto punë i përmbush zhanri i memuaristikës. Romani është projeksion i imagjinatës mbi të vërteta të brendshme, përmes "gënjeshtrave" sa më të guximshme, gënjeshtrave të "vërteta".

A mund të kemi një lexim "të fshehtë" të historive që shkruani, si i dëgjoni zërat e personazheve?

A.T: Nuk besoj se i më vetes një detyrë të tillë kur shkruaj. Përpiqem që historia që rrëfej të më përfshijë vetë në radhë të parë dhe të mos jetë e deshifrueshme, e parashikueshme në asnjë moment. Të mos ia qëllojë lexuesi, se çfarë pritet në faqen tjetër. Përftohet vetvetiu njëfarë thellësie, pa e rënduar dhe sofistikuar tekstin me "dijet" apo "filozofimet". Përpiqem t'i jap lirshmëri personazhit, ta lë atë të veprojë e të sillet me lirinë që ka dhe kufizimet që ka. Të jetojë. Pa sforco. Ato flasin me veten dhe të tjerët, reagojnë, gjithmonë në përputhje me identitetin që kanë. Gënjejnë, ngrehin rrengje, thurin plane e shpresa, njësoj si çdo njeri normal në botën e madhe të vërtetë. Dhe të vdesin besueshëm. Nuk mund ta vdesësh kot, pa motivim një personazh, meqë ti je autori dhe kështu të teket. Në jetë edhe mund të çmendesh. Të kapësh çiften dhe shtish mbi njerëz të gjallë në rrugë. Por kurrë nuk mund ta bësh këtë çmenduri të papërligjur në letërsi. Krimi në jetë edhe ndodh, por nuk mund të vrasësh në letërsi pa qenë e pashmangshme vdekja e personazhit. Floberi volli një javë kur i dha helmin Ema Bovarisë. Përgjegjësia në art është shumë më e madhe se në jetën e përditshme. Nisur nga këto shpjegime, kuptohet, që zërat e persanazheve të mi janë të dallueshëm në masën e çlirimit të personalitetit të tyre prej meje. Të paktën gjatë kohës që mendoj për ta dhe shkruaj "fatin" e tyre.

Për shumë arsye, këtu në Shqipëri (jo vetëm) mendohet se, shkrimtarët burra janë më të mirë se ato, gra, duke marrë një vel madhështie e rëndësie, çfarë mendimi keni, përse mund të ndodh kjo?

A.T: Unë nuk jam pjesë e atyre që mendojnë kështu. E di, si shumëkush, apo ndoshta më mirë se një pjesë e madhe, se ka prej kohësh një seri të studimeve "gender", letërsia feministe. Ekzistojnë kurse e programa të posaçme universitare e postuniversitare që trajtojnë "letërsinë feministe", duke plotësuar një gjenealogji historike të "shkrimit femëror". Unë mendoj se ka "problematikë femërore", por jo letërsi për meshkuj e letërsi për femra. Për mua letërsia nuk ka seks. Ose është letërsi e mirë, ose nuk është. Më duket absurde të provosh me indikator cilësinë "femërore" apo "mashkullore" të letërsisë. As nisur nga ndjeshmëritë "feminile" apo "mashkullore" nuk rezulton kjo. Jurij Lotman, një ndër semioticienët më të mëdhenj, krahason në një studim ndjeshmëritë "feminile" dhe "mashkullore" të dy poetëve rusë – Marina Cvjetajevës dhe Boris Pasternakut. Dhe e dini përfundimin e studimit? Lotmani argumenton ndjeshmërinë e spikatur burrërore të poezisë së Cvjetajevës, sikundërse ndjeshmërinë tejet femërore të poezisë së Pasternakut. E them edhe njëherë: letërsia e mirë nuk ka seks, d.m.th, gjini.

Cila është gjendja juaj mendore kur nisni të shkruani?

A.T: Pasiguria dhe dëshira. Cila do të fitojë? Varet nga koha. Shpesh mungesa e kohës. Alarmi i agjendës rrënon gjithçka. Madje për vite të tëra në jetën time, tash dhjetë vjet, ndoshta, mbizotëron alarmi dhe agjenda. Është luks të kesh një kohë të pahelmatisur nga radha e pafund e detyrimeve që të presin. Hija e detyrimeve e bën të pamundur të shkruarit.

Keni ndonjë shkrim të hershëm që nuk e keni botuar kurrë?

A.T: Disa dhjetra poezi, ca tregime dhe shumë fillime romanesh, tregimesh e novelash.

Cila periudhë e letërsisë shqiptare ka ndikuar tek ju? Vitet '900 nuk kanë vetëm komunizmin. Po nga

letërsia e huaj? Me intensitet edhe përktheni, duke iu kushtuar sidomos letërsisë ruse…
A.T: Lexoj pa paragjykim tradita të ndryshme. Zhanre të ndryshëm. Filozofi. Tekste biblike, kuranore, tekste shkencore. Në letërsi zhvendosem nga lirikët e tragjikët antikë tek moderniteti, mesjeta, etj. Jam një makinë leximi, mjafton të kem pak kohë. Mundohem t'i përmbahem një parimi kënaqësie nga leximi: nëse një libër që po e lexon nuk po të dhuron kënaqësi, dhe akti i leximit po shndërrohet pak nga pak në barrë, atëherë si çdo barrë tjetër e meriton të hiqet qafe. Dhe e detyroj veten ta hedh librin. Në traditat tona të letërsisë, mbetet letërsia e viteve '30. Koliqi, Kuteli, Migjeni. Laj, thaj, vetëm këta dhe Poradeci. Sigurisht ekziston dhe Prenushi, Shantoja, A.Pipa etj. Gjithsesi nuk të zhgënjejnë kur u rikthehesh. Para tyre - De Rada, Mjeda dhe Fishta. Po boll janë, apo jo? A kanë ndikuar tek unë? Si poet, jo. E prapë, ku i dihet? Ndoshta më shumë Mjeda me vargun e strofat neoklasike të përsosura. Po janë ndikime të tjera, që s'kanë të bëjnë direkt me shkrimin. Janë pjesë e ADN-së sonë tashmë dhe kushedi se kur e qesin kryet ndonjëherë...Letërsia e huaj është tjetër gjë. Romani im më i lexuar ka qenë "Don Kishoti i Mançës". Dikur e kam lexuar çdo vit. Por më afërt e kam ndjerë veten me modernistët – Prust, Kafka, Zamjatin, Bruno Shultz, Bullgakov, Nabokov. Romani i ashtuquajtur i estetikës postmoderniste gjithë e më shpesh më zhgënjen, me përjashtim të Kalvinos dhe Xhon Faullzit. Në poezi harta është shumë e larmishme nga shumë kultura. Por vazhdoj të mbetem e t'i rikthehem Brodskijt. Universi i tij me tërheq njëlloj, si në poezi, ashtu dhe në mendimin eseistik. Brodskij është një universitet i gjallë më vete. Përkthimet e mia janë shpesh mënyra vetiake leximi dhe dëshira për të bashkëndarë me të tjerët gjëra që mua më prekin. Nuk jam një përkthyes që jetoj me përkthimin. Përkthej ato që dua. Kryesisht nga letërsia ruse. Kam patur shumë plane për të sjellë një fytyrë të panjohur të letërsisë ruse të shekullit XX deri në ditët tona, por kjo mbetet deri më tash, jashtë mundësive të mia fizike. Nuk ka kohë për të gjitha...

Çfarë pasojash mendoni se, ka lënë tranzicioni nga regjimi komunist, qoftë në temë por edhe në formë?
A.T: Në letërsi vërshoi një liri kaotike. U dynd një pluhurnajë e madhe kulturore. Gjithkush që pati mundësinë financiare të botojë apo të gjejë sponsorizim, botoi librin e tij. Vërshuan rrëfimet e gjithëfarë lloji: libra për fshatrat, krahinat, dyert e mëdha, kishat, xhamitë e teqetë, për burra të shquar e patriotë, që deri dje nuk njiheshin; libra për mësues, oficerë, ushtarakë, ish-sigurimsa; çdo gazetar nxitoi të botojë librat e vet dhe të imponohet si shkrimtar me vlera. Po kështu veproi çdo politikan, aktor, pensionist, etj. Romane e poezi të autorëve që nuk e kapërcenin nivelin e vetëshprehjes. Në një kakofoni të tillë, shtëpitë-shtypshkronja botuese u sollën si çdo lloj i rëndomtë tregu, duke bërë preventivin e librit, pa e vrarë mendjen se çfarë vlere ka ai. Me kohë vendin e parë e zuri letërsia masovike, përkthimet e këtij zhanri (romanit rozë, i damave, thriller, dedektiv, mistik, erotik, konjukturoro-politik, etj), një zhanër që asnjëherë nuk është konsideruar si letërsi, se njëmend nuk është. Po me kohë iu bashkangjitën edhe produktet e letërsisë masovike shqiptare, edhe ato duke u konsideruar si fjala e fundit e letërsisë, prej ndonjë burri konjuktural me mjekër kombëtare. Të pakta mbeten edhe sot shtëpitë e mirëfillta botuese që mbajtën nivelin dhe qëndrimin e rezervuar të përzgjedhës të autorëve. Lexuesi e krijuesi shqiptar e ka mundësinë të ballafaqohet sot me gjithë emrat e mëdhenj në poezi e prozë. Dhe ky është një shërbim i mirë i botuesve shqiptarë. Sigurisht kjo ka ndikuar për një rikuptimësim të idesë mbi letërsinë si art i fjalës. Ndikimi pastaj ka qenë i ndryshëm, nga epigonizmi tek eksperimentimi i kujdesshëm. Sfera e letërsisë së mirëfilltë vazhdon të elitarizohet. Autorët shqiptarë po krijojnë profilet e tyre individuale dhe mund të flitet për një peizazh mjaft interesant të letërsisë shqipe bashkëkohore. Mirëpo sërish "Thembra e Akilit" mbetet rrjeti i shpërndarjes, i cili është krejtësisht spontan e i gjymtuar. Instanca nga Botuesi tek shpërndarësi dhe librashitësi nuk funksionon, të paktën për autorët shqiptarë. Në fund të këtij zinxhiri, pret surrati vrarëlie i librashtësit, i cili porosit librat me të njëjtin tahmin, sikur zgjedh trangujt në treg. Dhe ne nuk na shkon mendja si autorë, se gjyqtari ynë suprem për ekzistencë në raft, është inteligjenca e librashitësit.

Keni thënë: Kontrata me djallin është një metaforë e vjetër e njerëzimit, që në mënyrën e vet i shtrohet gjithkujt. Letërsia nuk është se i zgjidh këto probleme dhe nuk përçon moral në kuptimin e drejtpërdrejtë: në kontekstualizmin e kësaj, a ka ç'të rrëfejë sot letërsia?
A.T: Letërsia ka ç'të rrëfejë gjithmonë. Temat madhore dominuese janë po ato të lashtat: kthimi i heroit në shtëpi, tema e labirinthit, ndërmarrja e pamundur dhe kontrata me djallin. Sigurisht, ka dhe tema të tjera. Shoqëria e sotme shqiptare është e kapërthyer me të gjitha problemet e këtyre variacioneve tematike. Letësia nuk bën moral, sepse morali është gjë e trashë. Letërsia e mirë fsheh një apel, që ta pështpërit, si një urdhër i brendshëm, në një vesh ende të pazbuluar: "Bëhu si unë!"

Ndërkohë mbani pozicionin e Drejtorit në Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, angazhim dimensional –politik e qytetar. Përveçse ngjarjeve trondituese, çfarë ju shqetëson në këtë ndërgjegje sot?
A.T: Më shqetëson shurdhëria e politikës, parlamentit, komisioneve parlamentare dhe instancat e drejtësisë për të mos e ndëshkuar ligjërisht krimin komunist. Më shqetëson tejngopja e institucioneve qëndrore të shtetit me ish-Sigurimsa, një situatë flagrante kur shteti po drejtohet nga ish-Sigurimsat. E shkuara pasqyrohet në të sotmen: bashkëpunimi i ish-Sigurimsave me qarqet e ndryshme të mafies shtetërore. Ata i ke në Parlament, në Policinë e shtetit, në SHISH, në Prokurori etj. Madje dhe vetingu bëhet nga duart e tyre të ndyra, nga po ata ish-oficerë operativë të ish-Sigurimit. Shqetësuese është gjendja e kurrikulave mësimore në shkolla e universitete. Shqipëria ka probleme të rënda me ndarjen nga trashëgimia komuniste. Mungon ndjeshmëria dhe mirëkuptimi për ta bërë këtë ndarje. Shqipëria ka nevojë të zbatojë një Platformë Kombëtare të Dekomunistizimit dhe jo të riciklojë këto mbetje toksike sigurimsash në krye të institucioneve. Ata nuk e kanë më vendin në shoqërinë tonë demokratike. Efekti i kësaj ndotjeje të përgjithshme po na çon në ripërtëritjen e totalitarizmit.

Një kontribut është në atë që e quani letërsi e memuaristikës, që këtë vit pati sërish një fluks botimesh të reja mbi komunizmin, dëshmi e rrëfime…A ka kujtesë të mjaftueshme sipas jush?
A.T: Është bërë një punë e madhe nga Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit që drejtoj unë me botimin e këtij zhanri. Janë studime shkencore tematike e monografike të bazuara mbi arkivat, që evidentojnë harta krimi e gjenocidi. Janë mbi 100 tituj librash memuaristikë të qytetarëve që provuan burgjet dhe internimet. Disa qindra të tjerë që kanë mbijetuar i kemi marrë në rrëfime audiovizuale dhe po botohen të zbardhura nga Luljeta Lleshanaku në një kolanë që quhet "Zërat e kujtesës". Ka pasur dhe më parë përpjekje dhe ka edhe nga organizata të tjera, po prapë është e pamjaftueshme. Po përpiqemi të shpëtojmë kujtesën e të mbijetuarve, përgjithësisht breza të moshës së tretë, që po vdesin përditë.

Kur në vende të tjera leximet dhe performancat e tekstit poetik janë mjaft të përhapura, për t'i bërë vargjet më të arritshme, këtu për marrëdhënien poet-publik s'ka reflektim, dhe ishte trondituese sondazhi në fundvitin e shkuar për lexuesit shqiptar. Nuk lexohet.
A.T: Një peisazh letrar kombëtar, pa infrastrukturë, si i yni, nuk të lejon të shohësh vlerat e vërteta. Janë vite të gjata këto dhe gjendja ka ardhur duke u përkeqësuar. Infrastruktura letrare është sociologjia e komunikimit me lexuesin. Janë revistat, periodikët, almanakët dhe gazetat javore. Të gjitha këto media letrare, që tek ne mungojnë, duhet të jepnin një dinamikë të komunikimit. Ne jemi një kulturë pa revista, pa gazeta. Pa Festivale Letrare. Pa studio me emisione të posaçme, që t'i kushtohen cilësisht artit letrar. As rubrika të librit. Por edhe kur kanë qenë në ndonjë TV të madh, të kallte krupën era e qokave. Pyetja është: prej çfarë duarsh na serviret libri? Nga goca konjukturale, nga dama të perënduara ish-hartuese akt-ekspertizash. Kështu nuk ke mundësi të kuptosh se çfarë idesh, prirjesh, tendencash e stilesh mbizotërojnë. Nuk ke mundësi të lexosh një shkrim recensional, cikle poetike, përkthime, studime, sepse mungojnë.

Kjo është shenjë e keqe. Këto lexues që ftohen, që i kthejnë shpinën librit, janë kontigjenti i nesërm i rekrutimit në turma demagogjike, që shoqëria të kridhet në horizonte totalitare.

Si duhet t'i dorëzohesh lexuesit, a e mendoni?
A.T: Lexuesit nuk duhet t'i dorëzohesh, por t'i imponohesh me cilësi e veprave që shkruan. Kurrë nuk ka ngjarë në historinë e letërsisë, që poetët e shkrimtarët t'i dorëzohen masës së lexuesit. Lexuesi duhet "magjepsur" me atë çfarë e mban gjallë, duhet tërhequr me magjinë e letërsisë së mirë, ku ai të gjejë veten, jetën e vet shpirtërore e mendore, dilemat dhe dëshirat që e bëjnë të ngrihet nga banaliteti i përditshmërisë. Lexuesit duhet t'i ofrosh librin që atë e madhon, e bën të meditojë e të trandet thellësisht, të shkundet, të preket e të zgjohet nga përtacia shpirtërore. Duhet t'i ngacmosh sedrën. Diç të ngjashme me atë që thotë një personazh i Orhan Pamuk: "Sesi një ditë lexova një libër, që e ndryshoi tërë jetën time" ("Jeta e re"). A ka mundësi t'i ofrosh një libër të tillë? Do të ishe fatale t'i dorëzoheshe shijes së masës. Do të përfundonim në një letërsi kitch-i. Nuk i është dorëzuar Pushkini, Dostojevski, Çehovi, Hygoi, Prusti apo Kafka nivelit të lexuesit, por ata e kanë ngritur lexuesin në nivelin e tyre. Gjithmonë është fjala për lexuesin elitar, i cili është thuajse bashkautor me shkrimtarin në aktin e leximit.

Së fundi, nëse ju mund të jepni disa këshilla për autorët që aspirojnë, cilat mund të ishin?
A.T: Të lexojnë shumë e vazhdimisht. Të njohin mirë mjeshtërit. E të gjitha traditave. Të ushtrojnë stilin e tyre duke fshirë e grisur sa më shumë. Të shkruajnë "për vete", pa llogaritur në do t'u përshtaten lexuesve. Gjithçka tjetër mandej, zgjidhet vetvetiu.

Koço Qendro, empatia e Harpagonit 92 vjeçar

Ishte pothuaj një rast unik prezenca e aktorit 92 vjeçar, Koço Qendro në skenën e Teatrit, duke luajtur rolin e Harpagonit në komendinë e njohur të Molierit, "Kopraci". Me regji të Dhimitër Orgockës kjo shfaqje, si ndër të rrallat skena në Shqipëri, ka thyer rekordin e shfaqjeve në Korçë duke u mirëpritur së fundi, edhe në skenën e Tiranës. Qendro ka tërhequr vëmendjen jo vetëm për staturën e tij tipike, duke krijuar një empati absolute në skenë me personazhin e njohur të kopracisë, atë të Harpagonit. Me trupin e lehtë e të brishtë, aktori ka mundur të thotë fjalë për fjalë, atë që në estetikë krijon postulatin: personazhi jam unë! Nga rastet e rralla të figurës pas '90-ës në skenë, ku mendimi dhe përfytyrimi shkojnë në unison. Në raste të ngjashme Qendro është një zë "i vjetër" që ka freskuar skenën me një portret të munguar, edhe pse risku në një shfaqje e imazh të njohur ishte prapa shpine. Ky Harpagon që dha ky aktor, krijuar së pari në Korçë, në skenën që mbijetoi, dhe tani zhvillohet e plotë sikur të ishte në Tiranë ka mbajtur frymën e publikut. Kjo komedi është ngjitur në skenë në skenë në tri periudha të ndryshme kohore, gjithnjë me rolin e Harpagonit të interpretuar nga Koço Qëndro, që ka përfaqësuar edhe më parë me sukses të madh teatrin e Korçës si brenda edhe jashtë vendit. Koçoja kujton shfaqjen e parë të "Kopracit" në vitin 1986. Nën regjinë e Orgockës, komedia merr një nga temat më të goditura siç është kopracia duke zbuluar këtë në natyrën njerëzore, çfarë transformohet tek ai pas parasë. Kopraci fajdexhi dhe jeta e tij nën ethen e parave, si pasojë e kësaj marrëdhënie të ndërlikuar, çon deri në humbjen e dashurisë së fëmijëve. Ndërsa, luan për herë të dytë Harpagonin (2004, teatri i Korçës), aktori Koço Qëndro, ka kaluar edhe sprovën e skenës së kryeqytetit për lojën dhe energjinë e pashtershme në skenë, kur e njohim si një nga aktorët themelues të Estradës Profesioniste të Korçës, i cili në karrierën e tij artistike numëron mbi 120 role. Vepra u ngjit në skenë nga trupa e teatrit të Korçës, nën lojën e Blend Arifit, Ilda Pepas, Mateus Frrokut, Zamira Kitës, Blera Belliut, Refik Xhinakut, Syrja Meçes, Lazarela Detit, Valentino Hamatit dhe Antonio Toles. Muzika në vepër është realizuar nga Adrian Jorgji dhe kostumografia nga Bardhi Pojani.

Panairi i Leipzig - ngjarja në pranverë e tregut të librit dhe industrisë së medias për lexuesit, autorët dhe botuesit

LETËRSIA SHQIPE NË PANAIRIN E LEIPZIG

Marsi në Leipzig karakterizohet nga leximi. Panairi i Librit në Leipzig dhe festivali i saj i leximit "Leipzig liest" vlerësohen si ngjarjet e pranverës në sektorit e librit dhe medias. Autorët, lexuesit dhe shtëpitë botuese takohen për të mbledhur informacion, për t'u angazhuar në shkëmbim dhe për të zbuluar se çfarë është e re.

Në këtë intensitet për librin, ky edicion i panairit, që mbahet nga 21-24 mars, i kushton edhe letërsisë shqipe, pranisë së saj përmes autorëve. Një program i pasur takimesh të organizuara në stendën e Ministrisë së Kulturës, në stendën e rrjetit TRADUKI si dhe në hapësira të tjera të panairit dhe jashtë tij. Dy autorët e ftuar nga Ministria e Kulturës janë: Lisandri Kola dhe Saimir Muzhaka; dy autore dhe përkthyese të ftuara nga rrjeti TRADUKI dhe rezidenca e përkthyesve në Berlin: Lindita Arapi dhe Anrila Spahia (Ana Kove).

Sipas njoftimit të Ministrisë së kulturës, përveç të ftuarve dhe programit të pasur me aktivitete, prezantohet dhe katalogu në anglisht me veprat dhe autorët që kanë fituar çmimet më të rëndësishme të vitit 2018. Kështu Henrik S.G. me "Sonatë për gruan e një tjetri" fitues i Çmimit Kombëtar të Letërsisë, akorduar nga Ministria e Kulturës së Shqipërisë; Ardian Kyçyku me "Ati", çmimi i autorit të vitit nga Akademia "Kult", Virgjil Muçi me "Piramida e shpirtrave" , çmimi "Kadare" nga Fondacioni "Mapo", Brajan Sukaj me "Ciklopi", çmimi për krijimtarinë më të mirë të vitit akorduar nga Shoqata e Botuesve shqiptarë, Mitrush Kuteli (in memoriam) me "Përralla të moçme shqiptare", çmimi i Bibliofilisë, akorduar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Janë përfshirë gjithashtu në këtë katalog shkrimtarët më të njohur për vitin 2018 me botimet e tyre jashtë vendit: Ridvan Dibra, i nominuar për Çmimin Ballkanika me romanin "Legjenda e vetmisë". Gjithashtu ky roman i përkthyer në frëngjisht nga përkthyesja Evelyne Noygues dhe i botuar nga shtëpia botuese "Le Ver à Soie" është përzgjedhur në 5 librat më të mirë për Çmimin e përkthimit të vitit në Francë. Luljeta Lleshanaku, libri i së cilës "Negative space", ishte gjithashtu i përzgjedhur në 5 librat më të mirë për PEN Literary Aëard for Poetry in Translation. Për herë të parë në katalogun e autorëve janë përfshirë edhe dy përkthyeset më të suksesshme të vitit për përkthimet nga gjuha shqipe: Ani Gjika, përkthyesja e librit të Luljeta Lleshanakut "Negative space", finaliste për PEN Literary Award for Poetry in Translation, Evelyne Noygues, gjithashtu finaliste për Çmimin e përkthimit më të mirë në Francë. Takimi më i rëndësishëm në stendën e Ministrisë së Kulturës u bë të premten me temë: "Përkthimi, thembra e Akilit e letërsisë shqipe", ku në këtë panel diskutuan Lisandri Kola, Anrila Spahia dhe Mimoza Hysa.

Mircea Eliade "Miti dhe realiteti"



Vjen në shqip libri "Miti dhe realiteti" i shkrimtarit e filozofit rumun Mircea Eliade, përkthyer nga Azem Qazimi, botimet "Pika pa sipërfaqe". Eliade (1907-1986) njihet edhe si një nga historianët më të rëndësishëm të fesë në shekullin XX. Ai studioi në Bukuresht, Kalkuta, Paris, dhe ishte profesor i historisë së feve në University of Chicago nga viti 1957 deri kur vdiq. Eliade përpunoi shumë prej elementeve kyçe të shkollës fenomenologjike. Disa nga idetë e tij janë sot e kësaj dite pjesë e paradigmave kryesore të studimit të fesë në Perëndim. Në "Miti dhe realiteti", Eliade merr në studim ato shoqëri në të cilat miti luan ende rolin kryesor në formimin e tiparave kulturore themelore të shoqërisë: marrëdhënien e mitit me botëkuptimin, me konceptimin e historisë, kohës, me përvojën njerëzore në përgjithësi. Ja një pjesë e shkurtër e shkëputur nga libri: "Zor se mund të formulohet një përkufizim për mitin, që do të ishte i pranueshëm për të gjithë studiuesit dhe, njëherësh, i kuptueshëm për jospecialistët. Për më tepër, a është vallë e mundur të formulohet një përkufizim që do të ngërthente të gjitha tipet dhe funksionet e miteve në tërë shoqëritë tradicionale dhe arkaike? Miti është një realitet kulturor jashtëzakonisht kompleks, të cilit mund t'i qasesh dhe ta interpretosh nga këndvështrime të ndryshme dhe përplotësuese. Më ngjan se përkufizimi më pak i papërshtatshëm, duke qenë dhe më gjithpërfshirësi, është si vijon: miti rrëfen një histori të shenjtëruar; ai tregon një ngjarje që ndodhi në Krye të Herës, në kohën përrallore të "fillimit". Me fjalë të tjera, miti na tregon se si, falë veprimeve të Qenieve të Mbinatyrshme, u krijua një realitet i caktuar, qoftë ky realiteti në tërësi, pra Kozmosi, apo vetëm një pjesëz e tij – një ishull, një lloj bime, një lloj i veçantë sjelljeje, një zakon. Miti pra, është gjithherë shpjegim për një "krijim"; ai rrëfen se si është krijuar diçka, se si filloi ajo të jetë. Miti na tregon vetëm atë që ka ngjarë vërtet, atë që e ka shpërfaqur plotësisht vetveten..."

Një tufë me poezi nga Linditë Ahmeti, e konsideruar një zë solid, ku mendimi dhe ndjesitë gjejnë shtigje të ashpra për ta shndërruar gjithçka në katarsis energjie, si fjala vjen mbi kuptimësinë e jetës, ëndrrat dhe kujdesi për të ruajtur arketipin e saj poetik. Lindur në Prizren, poezitë e Ahmetit janë në "Zërin e rinisë" të Tiranës, në "Fjalën" e Prishtinës, në "Flakën e vëllazërimit" të Shkupit, në "Alternativë" të Lubjanës, në "Illyria" ShBA, në "Bota sot" Zvicër dhe në gazetën "Drita". Ka studiuar greqishten e vjetër dhe latinishten në Shkup, ku edhe jeton

LINDITË AHMETI
ISHULLI ADULAR

LULJA ALBA

Kur heliosi e derdh me grusht gëzimin
në qiellin e zymtë
e mbi fshatrat e përgjumura
e kur zana e mujit bëhet gati
t'ia lajë sytë omerit të ri
me vesë luleshqerre
këtu te ne
ku është çarë arka e shpresës
                këtu në ultësirë
                skaj një kaçube
përfundi një këpuce të vjetër
                të rëndë
                të fëlliqur
të vetëshkyer nga inati i fundit të vet
e të grisur nga thonjtë e mi
e shoqëruar nga rrezja e zbehtë e dritës
                së ftohtë
bashkë me thneglat e vyeshme
                me bletët
                me fluturat krahëshkruara
nis ta ngrejë kokën e bardhë
si me turp
por me krenari
lulja alba
e cila ndonëse nën ferrë
e nxjerr mbi botë bardhësinë
po pse nën ferrë
lulja e bardhë e liqenit nën ferrë
atëherë ia jep gazit mbi kullën time heliosi
e më zgjon



përballë meje s'ka kaçuba
                as ferrë
                as këpucë
duken vetëm liqenet e lurës
si stoli prej safiri
e mbi ta
me miliona lule alba
si barkat e afërditës së bukur
prej nga loz e përgjon erosi
me tufën plot shigjeta në shpinë
që i hedh bashkë me buzëqeshjen e tij
merr arbëri e bardhë
                vetëm dashuri
koordinatat e mëngjesit

TREKËNDËSHI

ikin retë e plumbta
vijnë të kuqërremtat
njëherë këto
pastaj ato
sërish këto
pas këtyre ato
kur bëhet ndërrimi
në kupën qiellore paraqitet
trekëndëshi
                i madh
                i dukshëm
vetëm për sytë e shkruar
tri anëza
tre brinj
tri kulme
në qiellin hapësirë ndërrimesh
qëndron trekëndëshi ngjyrë plumbi
i qartë si halli im
trekëndëshi
në qiellin që s'e nxjerr dot ngjyrën e vet
përmbi lisnajat pa gjethe
përmbi fushat me dredhëza që u ka rënë djega
trekëndëshi
me tri pika të dukshme
që janë tre rrathë
tri pasqyra
e s'dallohen pse shikojmë
                nga pozita më e ulët
nga ultësira ku rrjedh vrugtësia
tri pika janë ku kemi mbetur
jo s'janë tri pika po tre rrathë
tre rrathë ku kalojmë kohën
duke lozur vallen e rëndë
tri anëza
tre brinj
tri pika
tre rrathë
tre
trekëndëshi

AMERIKA IME

"Po të isha hënë
do të dija ku të bie"
D. H. Lawrence

hajt Selenë moj të lutem
lësho ndonjë copë adulari
t'i shohë shenjat Dreri i Bardhë
hajt Selena ime
t'i bëhesh fener Gjuhës së Zjarrtë
t'ia ndriçosh rrugën Qepallës së Përlotur
t'i bësh dritë Demit që Rri Ulur
i cili i prin kuvendit
me temën e vështirë
me klenë a mos me klenë

KUR MË VJEN AI ME MBRËMJEN

Kur ikën dielli matanë malit
Heliadat i lënë shenjat e buzëve
Me tkuq

Aty ku qiell përqafon bjeshkët
Duke i tërë perëndimi me shenja buzësh
të trëndafilta

Ngadalë pastaj
Lëshohet teposhtë drejt fshatit
Me fustan ngjyrë vishnje
Mbrëmja
E shoqëruar nga simfonia
E zogjve të malit

Që shkojnë të flenë
Të bartur në krahët e driadave
Plot verë
Që e ftojnë zefirin t'i përkundë degët
me çerdhe

Ndonëse hemera bie të pushojë
Mbi fshat mbetet gjallëria
Se e kanë marrë vesh
E dinë të gjithë
Ai do të më vijë
Ma dërgon vetë Zeusi
Mbrëmja e pret një copë nga fustani i saj
I mëndafshtë

E shton rrugën
Xixëllonjat varen në gjethet e drunjve
Për anësh

Llamba
Ai do të më vijë
Gratë janë bërë gërsheta
Nëpër dritare
Duan të vjedhin një grimë Nga bukuria
Që s'u takon atyre

Për të arnuar ëndrrën e grisur
Në fund - ndodhia
Ai zbret në formë të flluskës
E kur e çon dorën të trokasë
Në derën time
Rroket në një ferrë të kulumbrisë
E shkon me erën

Si balonë e shpuar
Lojë e Zeusit kjo do të jetë
Udhë e mbarë o çun i pritur
Udhë e mbarë o çun syshkruar

** Poezitë janë shkëputur nga vëllimi i dytë poetik i poetes, "Ishulli adular", Shkup 1996.*

Ardhja e kopjeve të para të "Mesharit" të Buzukut mbetet momenti më historik për gjuhën shqipe, të cilën e ka përshkruar At Justin Rrota në librin e tij "Për historinë e alfabetit shqyp", botuar së pari në Shkodër, nga Shtypshkronja Françeskane, në vitin 1936, që njohu botimin e dytë në vitin 2005, duke nxjerrë nga heshtja gjysëm shekullore librin e parë shqip, sjellë në tri kopje

BUZUKUN LYPNI?

Nga AT JUSTIN RROTA

Ma të parat kopje të fotografueme të Buzukut ndë Shqipëni

Ende i ri me moshë, sado i ligshtuem kahë shendeti, unë, aso pranvere 1929, jipshem gjithënjë mësim gjuhët ndër klasët e nalta të gjimnazit.

Lajmi i shpallun atëherë prej fletoresh e revistash mbrenda e jashta Shqipëniet, se gjindej ndër arkivat e Romës një kopje e librit ma te vjetrit shqip (1555), qyshë ndë fillim më kishte trandë e elektrizue. Më dukej si çudë, nuk e kuptojshem dhe griheshem vetë me vete kahë mendojshem, si mund të rrijshin indiferente sidomos masat intelektuale ndë një Shqipëni, Shtet ndë vete, ndaj visarit buzukjan!

Kahë s'më linte e keqja e atij monumonti jetik, vorrue nd'errësin' e libravet të hueja larg atdheut, nd'atë pakicën teme, gji'thësa munda dhe gjithësa dijta, nxita e mërzita të madh e të vogël, ta kapshin ma me zell çashtjen e çimelit ndë fjalë.

U desh do kohë djeri që ata, të cilët kishiri punë ndë dorë, t'a kuptojshin randësin' e dokumentit dhe t'a shndrojshin ndë realitet dëshirin e vullëndetmirëvet.

Sigurisht, jo po: si ma kompetenti, por… s'e dij; ndashti pse u dëftova aqë entuzjast, qeshë zgjedhë vetë për këtë misjon; d.m.th. të siellshëm ndë tokën Shqipëtare, — mbasi s'ishte e mundun- kopjen origjinale, që njihet e vetmja ndë botë, — ndëmose librin e fotografuem, qe të mundshin kështu studjuesët e pastudjuesët me e kundruem pasqyrën e shqipes së folunë prej së parësh si në shokullin fill mbas deket së Skunderbeut.

* * *

U nisa. Por, shi ate ma të parë natë ndë cilën mbërrina ndë Romë, krejt entuzjast për misjonin tem, m'u prish. Kur më qiti rasa t'ia përmendshem dikuj qëllimin, për të cilin kishem ardhë, m'a priti truq: «Edhe unë mirrem me kësosh punësh, jam hulumtues dokumentash të vjetër". Por, po kam keq të ju thom një fjalë: Kini ardhë ndë një kohë të keqe. Këso ditësh vapet, bibljoteka, me të cilën kini punë Ju, ashtë mbyllë, mbasi personeli gjindet i shpërndam ndër pushimet verore".

Ato fjalë me ranë si ujët valë. Me kaqë, ideali dhe entuzjasmi, me të cilin ishem nisë për këtë udhtim të jashtëzakonshëm, automatikisht binte poshtë. Shto shpenzimet, dhe… ma zi marrja, se dami. Misjoni im; barra m'e zhvorrue Buzukun, erdh e m'u pështjellue aqë, sa, për një ças u pendova, pse ia kishem hy ndopak.

Kishem ra, pse kështu kishem urdhën, ndë një monastir të përbam prej fretënsh spanjollë, vetëm prej kësish. Tashti, për fat temin aty banon te edhe një frat piktor, i dërguem prej provinçës së vet, për të nxjerrun kopje nga origjinalet e kryevepravet të Pinakotekës së Vatikanit. Artisti, A. Eugjeni ishte fort i njohtun ndër ato ambjente: kishte teserën me hy e me dalë pa taksë. Ndë gjithatë demoralizim ku gjindeshem, m'u duk një ndërmjetës i aftë, për të më çelë shteg nd'atë punën teme. Prandej, unë, gjithëkund bisht mbas si, A. Piktori kishte aty ndër Muzejt e përmëndunë një zyrtar, kolegë të vetin: bashkëvëndaa. Hapat e gjurmimit të parë i filluem te ky.

Para së gjithash na drejtoi te një rojtarësh së Bibljotekës, te një plak. Aty morme vesht, se arkivet ishin gjithënjë çelë; edhe pamë vizituesët, që hyjshin e dilshin… M'erdhi fryma!

Bana si bana, e të nesërmen hyna edhe unë ndë Bibljotekë. Mirë se hyna, por ku do t'ua nisshem kërkesavet, unë, që, përposë emnit t'auktorit dhe të titullit të trilluem të Mesharit, nuk kishem kurnjë shenjim tjetër?…Duhet me u gjetë mbrendë nd'atë pyllë të dendun librash e dokumentash, sikurse gjindeshem une atë ditë për ma të parën here ndë jetën teme, për të pasun iden, çka ashtë ajo Bibljotekë!

Më drejtuenë te sekcjoni i ungjijvet të vjetër: Dorëshkrime artistike, apor inkunabula, të lidhunë shumica me lëkurë apor edhe ndër përgamene; disa, të mëdhaj sa une ndë kambë. E e siellshem prej fundit mbë krye katalogun e atyne punimeve të vjetra: Ungjij gjithnduerë gjuhësh, ritit e stilit. Por, ç'dobi? Shqip, kurrgja, kurrkund!…

E vijova unë për do dit të mira ndër këto kërkesa të pafrytshme. Vijova djeri që një ditë m'a bani njeni rojtarësh: "D. Çiril Korolewsky, ai mirret me këso shkrimesh e botimesh së soçme liturgjike të kishëvet orientale"- Edhe m'a dëftoi tavolinën ku punonte.

Por mjerisht aso ditësh, ndërsa unë ishem nder grepa, tryeza e tij shihej gjithmonë thatë. Ku ishte D. Korolewsky?…Kishte shkue – më thanë- diku ndër rrethet e qytetit për pushime verore. Por, me siguruenë se, mbas fjalës së lanunë, nuk kishte vonesë.

Edhe unë, për ditë nade, punën ma të paren, sa shkojshem ndë bibljotekë; me pyetë derëtarin, a kishte këthye D. Çirili!

Nuk kaluenë shumë dit njimend, edhe një rojtar m'a dha lajmin e gëzueshëm, se tek e mbramja i dëshruemi kishte mbërri natën para.

E prita. Për nji që me pau, m'a bani: "Po a Ju jini ai Frati nga Shqipënia, që më kërkoni tash një javë? Buzukun lypni? Qe; më falni sa t'i ap fund njëkësaj letre që kam ndë dore, edhe Jua pruna. Të më kishte thanë, sa, m'ishte ngjalle prej vorrit njëni robësh së mi te dekune, nuk e dij, se do t'ishem gezue ma fort. Sa s'kjeshë tue i ra ndë gjuj përpara, me i puthun kambën. Kaq!

Tre minuta, nuk vonoi ma, për t'a krye atë shkresë, por mue m'atohere, kur e kishem, si me thanë, Buzukun nde grusht, ata minuta m'u duknë orë.

Dikur u çue, e la tavolinën; edhe, pa më thanë mue gja, shkoi e humbi mbas do raftesh së mëdhaj librash, sa… Nuk vonoi sa ndora, kur, si triumfalisht, m'a dorëzoi blenin e dëshruem. Sa s'qava prej gëzimit. E mora ngrykë Buzukun e dashun, e putha me nderim edhe u vuna mbë tryesën e madhe të studjuesavet. Edhe nisa t'a shfletsoj si i dëshruem me mall e poni, njashtu sikurse shfletohen letrat e shtrënjta të njëj miku të vjetër… Kaqë i kishem këcye përsipri atij visari të çëmueshëm, sa më bje ndër mendë, se njëni rojtarësh m'u afrue e më tha ndë vesh: -Më kadalë! Këqyrni, mos t'a damtoni tue e shfletsue: ashtë gja e vjetrë -… Mandej jo vetëm me i vu duerët sypri!"

Kishte arsye, e pashë, të m'i qitte ndër mendë rregullat ma elementaret e këtyne rasave; por, ç'ti bajsh!… Unë atëherë kishem tretë faret dhe s'dijshem ku ishem prej gëzimit e mallit. Këndova mbë te sa këndova, djeri që u ba koha me i lirue salonat e leximit.

Njashtu edhe nd'e nesret e nd'e mbasnesrit; s'kishem të ngim. Një herë së parit rishtar i pamësuem me stilin dhe grafin buzukjane, ngurojshem. Por, menjëherë ia mora dorën leximit, dhe s'm'u bante ma me e lëshue. Nuk e tora gjatë. Fil njaty të tretën a të katërten ditë mbassi u këndaqa me të, u informova për fotografistin e bibljotekës. Më paraqitnë një farë Sansaini-t. Pashë modelat, i zgjodhmë, dhe ramë ndë godi për çëmim. Venduemë me i a hy punës pa tjetër: me fotografue krejt Mesharin, me m'a lidhë – dy kopje nde lëkurë, njenën nde rason. Për këto punime më kërkoi Stabilimenti nj'a tri javë afat. Edhe unë ndë këtë ndërkohë e lashë Romën, e dola me kërkue ngjeti për dokumenta të shqipes.

***

Ndë krye të tri javëve, t'u këthyemen ndë Romë, puna ma e para, m'u pjekë ndë fotografistin sypermarrës. Stabilimenti Sansaini i kishte ndjeë përpikënisht kontratës. Kur m'i qiti me i pa blejt e lidhune, më qeshi buza, ma fort zemra.

Sadoqë për dukë t'a këndaqshin synin, tue i shfletsue vërtetova, se reprodukcjoni ndër të tria kopjet nuk ishte ashtu i pastër dhe i qartë, si e kishem dëshruem. M'u prish pak. E po, thashë, cila vepër njerëzore mund të dalë prej doret së mjeshtrit krejt pa kurnjë të metë a njollë? Por prap mendova, se njëni vend i mbyllët i kopjes a) mund të ndriçohej me tekstin e kopjes b). Më kishte marrë mëndësh fotografisti me të lidhunt aqë elegant, sidomos t'asaj me rason; e… s'i bana ma fjalë.

U gëzova sa s'ka posaçe kahë mendojshem se me kaqë misjoni im kishte marrë një përfundim të mirë, e se tash mund t'u këthejshem ndë vend tem me ball hapët.

I dhashë drejtimin, të m'i binte ku rrijshem: SS. Quaranta. T'i marrmen ndë dorëzim "Buzukat" e lidhunë, aty për aty i a pagova sypërmarrësit punën: përsa më bje ndë mendë, nga 1200 lt. kopjen. Tre blejt ndën sqetullë, me atë fill ngava të Libreria e famëshme "Desclee". I porosita të m'i impakojshin sa ma mirë dhe të m'i sigurojshin me garansit ma të fortat të zyrës postare. Ndërkaq i hoqa edhe vetë spirancat prej Romës edhe mora drejtimin kahë vendi im. Çka do të bajshem ma rrugash? …Një javë, nuk e besoj se vonoi ma tepër; edhe qe, se m'erdhi lajmi i zyrës së postelegrafës, që më njoftonte, se Buzukat kishin mbërri ndë doganën e qytetit.

***

Sa i vogël edhe unë!…Këndaqeshem tue i këqyrë ata tre blej. Si të kishem ba një punë të madhe!



FREDERIK RRESHPJA
INTENSAT SHKRIMORE DHE LIRIKU I RRALLË I LETRAVE SHQIPE

Nga Behar Gjoka



Paprania fizike e shkrimtarit është një ngasje e fortë për tu marrë, vetëmse me tekstet letrare. Për krijimtarinë e gjerë letrare, e sidomos për lirikën e Frederik Rreshpes, mund të flitet hapur, pa drojën e keqkuptimit. Po ashtu, në këtë kontekst, me vlerë është marrëdhënia e letërsisë me kohën, si shkrim dhe kohë e pakohësisë, së leximit dhe verifikimit të shenjave artistike. Për të qartësuar këtë marrëdhënie, tejet të ndërlikuar, vlen sugjerimi:

Koha e veprave nuk është koha e kufizuar e të shkruarit, por koha e pafundme e të lexuarit: hapësira letrare është kujtesa e njerëzve. (Clark, 2002: 63), i Ceneth Clark pohuar në librin *Qytetërimi*.

Ligjërata që ka në qendër krijimtarinë letrare të autorit, veçmas të natyrës dhe vlerave që bart poezia, parashtron kërkimin e tipareve të shenjave estetike, shtjelluar në këto çështje:

Intensat shkrimore të shumëfishta.

Dykohësia e ligjërimit poetik.

Liriku i letërsisë bashkëkohore.

Rreshpja, lëvrues i lirikës së pastër.

Problematika e gjerë e secilës prej këtyre çështjeve, kërkon një hulumtim me të thelluar, si dhe të shtrirë në kohë, për të cekur dhe shqyrtuar tipologjinë e larmisë letrare, të rrokshme në dy kohë, me pikësynim për të analizuar poetikën e sendërgjuar në lavrimin e lirikës.

Intensat shkrimore të shumëfishta

Hemisferat e shkrimit letrar, në gjallje të shkrimtarit, japin dorë për të kuptuar njeriun dhe krijuesin, që ka udhëtuar nëpër dritëhije, në burgje dhe përgojime, mjerim dhe në jetën e zakonshme të bohemit, që ndërkaq ia ka mbërritur me mbijetu në shtjellat e realizmit socialist, po kaq, që ka shkruar në gegnisht në fillesat e veta, e mandej në gjuhën e njësuar. Megjithatë si pak të tjerë, të kohës së letërsisë shërbesës, ia ka mbërritur të lërë gjurmë në disa rrafshe letrare. Në krye të mëtimit për të shqiptuar vlerat e krijimtarisë së gjerë letrare të shkrimtarit, shpalohet:

1 – Poezia, e cila fytyrëzon të mbërrimet më të rëndësishme të autorit, niset me përmbledhjen "Rapsodi shqiptare" e vitit 1967, "Në këtë qytet" 1973, "Erdhi ora të vdes përsëri" më 1994, "Lirika" më 1996, dhe mbyllet me vëllimin më të plotë, "Në vetmi" në 2004. Trashëgimia poetike, është vënë në qendër të analizës së vlerave estetike që përçojnë librat e autorit.

2 – Shkrimi i prozës zë fill më "Tri përralla për fëmijë" në 1968, "Trimi i fshatit Bardhë", "Eranda" më 1969, e cila përfshin romanin "Zëri i largët i kasolles" më 1972, ku ndeshim prozën për fëmijë dhe për të rritur, të cilat duhet të analizohen në të gjithë treguesit e vetë formësues.

3 – Tekste dramatikë, në vitin 1972 boton dramën "Ëndrra e tokës" dhe "Trofta hutaqe" më 1973, që e përmbyllin pasurinë shkrimore të botuar në gjallje të autorit, pa humbur fillin se ka gjasa të ketë dorëshkrime të tjera, jo vetëm si hamendje, që me kohë do e shohin dritën e botimit.

Proza dhe dramatika e shkrimtarit, do të jetë në vëmendje më të plotë në një moment tjetër, kryesisht për të zbërthyer kahjet ligjërimore të trashëgimisë letrare të shkrimtarit, sepse në këtë rast ligjërata ka vënë në fokus kryesor poezishkrimin. Plotënia e dëshmive shkrimore, ma tepër një përcjellje panoramike e realizuar këtu, nga njëra anë përplotëson figurën e autorit, dhe në anën tjetër, nxjerrë në një dritë tjetër, lirikën e larmisë, shenjën emblematike të Rreshpes, si një ndër autorët e rëndësishëm të letërsisë bashkëkohore. Lavrimi i poezisë në kohështrirje dhe tipologji të laryshisë shprehëse, sjellë në vëmendje momentin tjetër, po kaq thelbësore për të evidentuar shenjat letrare:

Dykohësia e shkrimit poetik

Lirika, ose shenja identifikuese estetike e Rreshpes, si lavrues i poezisë, megjithatë formësohet në dy kohë:

Fillesat e poezisë, ku përfshihen librat: "Rapsodi shqiptare" e vitit 1967, "Në këtë qytet" e vitit 1973, që në krye të herës janë shkruar në gegnisht e më vonë janë kthyer në gjuhën e njësuar, një dëshmi e ndërlidhjes me kontekstet e shkrimit letrar në gjuhën shqipe. Përmbledhjet poetik të para viteve '90, pavarësisht vellosë së endur, ku ndërkaq zbulohet atmosfera e kohës, e shoqëruar me përllomjen ideologjike dhe sociologjike, që e pati mbërthyer letërsinë shqipe, e cila në shumicën e vatrave ligjërimore notonte në kthetrat e realizmit socialist. Megjithatë, shpesh herë në hapësirat e teksteve poetike, plazmohet fytyra e poetit që ikën nga koha e tij, ndonëse mbetet e përfshirë në ideologjemën e kohës, ku shqiptohet ama lirike.

Shqiptimi i përmasave të plota të poetit pas viteve '90, kur hapi sirtarin e ditareve dhe të shpirtit, të ndragur në burgime dhe spiunime, tallje dhe zvetënime, si një rrethanë e shpalimit të poetit lirik. Vëllimet e botuara në këtë periudhë, si "Erdhi ora të vdes përsëri" më 1994, "Lirika" më 1996, dhe "Në vetmi" në 2004, shqiptojnë dhe përmbyllin lavrimin e poezisë prej poetit, si dhe përfaqësojnë rrafshet e lirikës së njëmendtë. Vargu, fjala, poetika e shpaluar në këto përmbledhje të mbrame të autorit, formësojnë lëvruesin unik të lirikës, në melodikë dhe sublimimin e unit poetik. Fakti i pohuar shpesh nga studimet letrare, se "ujëdhesa" kreative ma e qenësishme e F. Rreshpes, është lirika, vetiu na nxjerrë në shtjellimin e çështjes së tretë të kësaj ligjërate:

Liriku i letërsisë bashkëkohore

Lirika e Rreshpes, e lexuar në kohë dhe hapësirë, megjithëse pa ia mbërritur ende që të vendoset në meritat e shenjimit të letrar, në hartografinë zyrtare, ndonëse shpesh herë është përfolur si poet i lindur, madje poet unik, në letërsinë shqipe bashkëkohore. Mungesa e poezisë së Rreshpes në këtë hartografi të përfaqësimit të vlerave të njëmendta poetike, ka shumë shkaqe, letrare dhe jashtëletrare, të cilat nuk mundet të paraqiten këtu në të gjithë përbërësit e vetë. Megjithatë, prania ose mungesa e poetëve, të djeshëm dhe bashkëkohorë, e sidomos e teksteve letrare, përpos të tjerash, po ashtu lidhet ngushtësisht me hierarkinë letrare të projektuar në motet e realizmit socialist, që me sa duket atëherë kur u hartua, nuk e pati në llogari Rreshpen dhe veprën e tij letrare. Ndërkaq, prej tridhjetë vitesh, koha kur ka rënë sistemi dhe modeli zyrtar, porse mjerisht hierarkia e vlerave letrare, tashmë e ngurtësuar, është vepruese si dikur, madje rikthimi dhe vlerësimi, gjithnjë jashtë hierarkisë zyrtare, i poezisë së Rreshpes dhe gjithë shkrimtarëve të tjerë, sërish mbetet e ndërvarur nga hartografia e vlerës së hierarkisë letrare. Një poet bohem si Rreshpja, një poet i toneve të pastra lirike, nuk di se çfarë mundet t'i ofronte hierarkisë së realizmit socialist?! Hija e hierarkisë letrare të kohës dhe modelit të realizmit socialist, edhe gjatë kësaj kohe, është aq e fuqishme, sa nuk lejon kthimin real në panteonin e letrave shqipe, të disa prej mjeshtrave të letërsisë së mëparshme dhe të asaj bashkëkohore, eventualisht edhe të poezisë së Rreshpes. Hierarkia letrare, e përjashtimit të disa autorëve dhe teksteve letrare, hartuar para viteve '90, ende vijon që të mbetet si një perde e hekurimtë, që pengon lëvrimin e lirë të letërsisë edhe, në shekullin e njëzet e një. Pentagrami poetik i Rreshpes, më përtej kohës shkrimore, nginjur në motet e shërbesës ideologjike, e kohës kur letërsia u kthye në propagandë, së paku, duhet verifikuar në dy rrafshe:

A – Në marrëdhënie me lirikën gjithkohore të letrave shqipe, ku përveçohen lirikat e Zef Serembes, cikli "Bukuria" i N. Frashërit, cikli "Vajet", i A. Z. Çajupit, e veçmas lirika e Lasgush Poradecit, erotike dhe e natyrës, që përkon me kulmin e lirikës shqipe, gjithëkohore dhe në gjithëhapësi. Në poezinë e Rreshpes, përveç frymës lirike, jo rrallë ndeshen emrat dhe vargjet e këtyre lirikëve të letrave shqipe, që të vënë në mëdyshjen e parapëlqimit të atmosferës së lirikës së mëparshme, gjë që poeti nuk e fsheh, madje e përçon lirshëm në tekstet e poezive. Në një kuptim më të ngushtë, me shkrimin lirik të Rreshpes, realizohet ajo që pohonte dikur T. Elioti:

Asnjë poet, asnjë artist i cilitdo art, vetëm nuk e ka kuptimin e plotë. Rëndësia e tij, të çmuarit e tij është të çmuarit e marrëdhënies së tij me poetët dhe artistët e vdekur. (Eliot, 1982: 15), tek libri *Ese* ***të zgjedhura***.

Në dimensionin lirik, finesën dhe brishtësinë ndjesore, lirizmin e ngjyresave, e sidomos për shpalimin e poetikës erotike, anipse në hapësirën e këtyre teksteve mbizotërojnë notat vetjake, lirika e Rreshpes vijon lavrimin e lirikës së mjeshtrave të shqipes, ku më së shumti avitet me poezinë e Poradecit, jo si përqasje tekstologjike, por si frymë thadruese e lirikës, me gjasë si atmosferë e kumteve të poetikës së lirikës së pastër.

B – Në marrëdhënie me kohën e tij, e cila është më e ndërlikuar, me poezinë e shkruar në të dy kohët, ku lirika në motet e realizmit socialist, shihej me dyshim dhe më tepër trajtohej si vatra ku flenë "djajtë", situata është më e komplikuar. Për të hetuar dhe shenjuar, dukshëm dhe përfundimisht, peshën e lirikës së poetit, në marrëdhënie me bashkëkohësinë, e sidomos me estetikën e shpaluar,

është gati e pashmangshme, vendosja në ato kontekste, si dhe përqasja përkitazi, me lëvruesit e poezisë së kohës. Në rrethanat e ushtrimit të trysnisë ideologjike, mbi poezinë dhe lirikën, krahas klimës jashtëletrare, një ndikim të madh, pati shfaqja në horizontin e letërsisë shqipe, e tre poetëve të brezit të viteve '60, D. Agolli, F. Arapi dhe I. Kadare, ku madje qysh në krye u theksua, që ata me librat poetikë, kryen përmbysjen e madhe, gjithnjë simbas studimeve të mëparshme, sepse bazuar në përfundimet e studimtarisë letrare, e futën poezinë shqipe, në risime të njëmendta. Në distancë të mjaftë kohore, ndërkaq kupton se prezantimi i aktit dhe trashëgimisë poetike të asaj breznie, pavarësisht novitetit të rrokshëm përmbjatësor dhe formësues, megjithatë ky hark kohor ka këputur lidhjen me poezinë e mëparshme, me letërsinë shqipe të trojeve, si dhe përgjithësisht la në hije poetët e lirizmit të errët, një term që mbizotëronet në atë kohë, kur flitej për poezinë lirike. F. Rreshpja, me lirikën e laryshisë, që në verb dhe frymë, shpreh më tepër kozmogoninë e shpirtit, hyri në komunikim me lexuesin, me shumë vështirësi në periudhën e parë, kurse pas viteve '90, lirika e tij, rizbulohet në gjithë dimensionet. Për të kuptuar njeriun dhe poetin, intelektualin dhe rebelin, ndërlikesat e kohës, përdorimin dhe shpërdorimin e figurës, të situatës komplekse të fatit të poezisë, ndërkohë që fati i Rreshpes, në disa aspekte, ngjan me fatin poetit rus, Esenin, që i fali gjithçka revolucionit, por jo lirën e tij, pra jo poezinë. Pjesë e poezisë bashkëkohore është edhe Martin Camajt, i munguar dhe ndaluar gjer në vitet '90, që me lirikën abstrakte, siç nënvizon Nehas Sopaj, teksa shqyrton përmbledhjen Buelli, nënvizon: … *ndesha një abstraktsion të lartë gjuhësor, një hermetizëm të skajshëm figurativ në nivel të mitit konkret…(Sopaj,*1999: 123, revista Stil, Shkup, "Bomi". Martin Camaj me veprën e gjerë letrare, veçmas me poezinë, kreu dy akte madhore, ligjërimin në gegnisht, si dhe e ndërlidhi poezinë shqipe me poezinë moderne të përbotshme, të cilat i vënë breron e njërit ndër poetët më të rëndësishëm të letërsisë bashkëkohore.

Rreshpja, lëvrues i lirikës së pastër

Leximi i lirikës së Zef Serembes, Lasgush Poradecit dhe Frederik Rreshpes, kuptimësohet dhe shijohet, në mënyrë të veçantë duke e vendosur në vatrën e lirikës së pastër. Në këtë diskur për ngjyresat e lirikës së Rreshpes, për të hedhur sadopak dritë në këtë aspekt të shkrimit poetic të autorit, ndërkaq shpërfaqen dy momente, që kërkojnë interpretim dhe argumente të thelluara:

A – Çfarë kuptohet me purolirikë?

B – Poezia e Rreshpes dhe shenjëzimet e lirikës së pastër.

Purolirika, nga ana tjetër, si nocion teorik dhe mishërim i lirikës së pastër, në poezi apo edhe në prozën poetike, përbën një aspekt të rëndësishëm, që në studimet letrare të shqipes, gati – gati është në fillesat e shqyrtimit. Kjo pistë e verifikimit të lirikës, si tipologji e shkrimit të lirikës së pastër, duhet thelluar në shqyrtimin e poezisë së enduar në letrat shqipe. Lirika e pastër, në thelbin e vetë ekzistencial, buron nga shkrimi i poezisë, që sendërtohet përmes një procesi të ngjeshur, ku shpirtërorja dhe derdhja melodike e saj, si një shkallë e ngritur e abstraksionit gjuhësor, që pothuajse e braktis brendinë. Hedhja e vështrimit në libra me poezi të Edgar Alan Po, Sharl Bodler, Paul Valeri etj. , të bind përfundimisht për ekzistencën dhe magjinë e poezisë së pastër. Purolirika, diçka më tepër edhe si një vetëshpjegim, formulohet dikur nga E. A. Po, teksa shprehet:

Kjo etje i takon pavdekshmërisë njerëzore. Ajo etje është pasojë dhe shenjë e ekzistimit të përhershëm. Kjo është ëndrra e fluturës së natës së pas yllit. Po kjo është vetëdija për të bukurën para nesh – por përpjekja jonë e pakufishme që ta arrijmë të bukurën mbi gjithçka. (në esenë ***Parimi poetik***)

Në lirikën e pastër, pra në poezinë e melodisë lirike, çasti i fanitjes së poetit, natyrshëm shkrihet në çastin e përjetimit të lexuesit, si dhe më në fund shpaloset në vargje si një perceptim bashkëtingullues. Nëse lira, pra vegla muzikore, sidomos në antikitet shoqëronte vargjet poetike, në kontekstet e ndarjes me të, poezia gati-gati shndërrohet vetë në lirë, pra në melodi ku shpirti i poetit, vetvetiu shkrihet me shpirtin e lexuesit. Megjithatë, realiteti i "përlindjes" së lirikës melodike, pra tashmë pa lirën që lëshon tinguj, e cila vjen me poezinë e shqiptuar si muzikë, materializon dhe shpalos tiparet e purolirikës. Kreativiteti "hyjnor" i lirikës së pastër, ma së pari përcaktohet nga dija teorike letrare, e cila lëvrimin e poezisë së shpirtit, e poezisë melodike, e kërkon në optika të verifikimit specifik. Ideja që thekson ekzistencën e purolirikës, formësohet më herët nga Henri Bremond, në librin ***La poesie pure***, (Bremond, 1926: 16), kur nënvizonte:

…çdo poezi e shpreh aspektin e vet të pastër poetik, praninë rrezëllimin aksionin transformues formues dhe unifikues të një realiteti misterioz që ne e quajmë poezi e pastër.", që në fakt zbulon, përpos të tjerash, një rrethanë të shfaqjes së surrealizmit në art dhe letërsi, e cila gërsheton konkreten dhe imagjinaren në atë njësi unike.

Leximi i lirikës së Rreshpes, si shenjë e lavrimit të purolirikës, është një proces i hapur dhe tepër i vështirë. Duke qenë lëvrues i lirikës shoqërore, politike, qytetare dhe erotike, me gjurmë të lavrimit të purolirikës, është e pashmangshme shkartisja e teksteve, në tanësinë e magjesë shkrimore të librave të botuar. Fakti gjuhësor, i shkrimit të poezive të para në gegnisht, e mandej të konceptuar në gjuhën e njësuar, është një çështje më vete, që kërkon vëmendjen e studimeve, gjuhësore dhe letrare. Në marrëdhënie me letërsinë, e zhanreve të ndryshme letrare, ndërkaq Rreshpja ka lidhje organike me poezinë, madje diç më tepër ka lidhje të ngushta me lirikën e pastër. Gjurmët e lirikës së pastër, me stilema gjuhësore dhe ngjyresa të purolirikës, hasen në gjithë librat e autorit. Në mes poezisë së botuar para viteve '90, ku veçohen "Rapsodi shqiptare" e vitit 1967, "Në këtë qytet" e vitit 1973, lirika ekziston, ndonëse paraqitet më e fshitur në ngjyresë, prej rrethanave të trysnisë së realizmit socialist, lirika e shpirtit, kundrohej shtrembër, aq sa mjellma e pozisë shqipe, Poradeci heshti gjatë, nuk botoi poezi në klimën e zhurmës ideologjike. Këto libra janë pjesë e atmosferës së kohës, e megjithatë aty ndesh prani të nuancave të lirikës së pastër, në tematizimin meditativ e sidomos në shprehësinë letrare. Krejt ndryshe ngjet me librat e botuar në periudhën e dytë, ku përfshihen librat "Erdhi ora të vdes përsëri" më 1994, "Lirika" më 1996, dhe "Në vetmi" në 2004. Përmasat e lirikës së pastër, të lirikës melodike të shpirtit vetmitar, që komunikon me botën përqark, me rruzullin, shqiptohen vetëm me zërin e vetë. Sendërtimi i lirikës së pastër, në tre libra e mbramë, tregon se kemi të bëjmë me vetëdije letrare të shkrimit të purolirikës. Ky fakt letrar, dëshmuar në tanësinë e vetë, por që në këto libra, shpërfaqet me tonalitetin e vetë të plotë, tregon se jemi para një sistemi poetik të përveçëm. Një sistem poetik, që mishërohet në morinë e poezive, të vargjeve të larmisë, të stilemave gjuhësore që rrokin melodinë e shpirtit, të gdhendur në shkronja. Këtu po sjellim një lexim dhe rilexim të thelluar në tekstet e poetit, që dukshëm mishërojnë tiparet e lirikës së pastër. Madje, është një zgjedhje e vetëdijshme, që anon nga sendërgjimi i një mënyrë vetjake të thadrimit të poezive, që ka formësuar sistemin poetik, në letërsinë bashkëkohore. Rrethanat e shkrimit, kontekstet e leximit, që përgjithësisht e tejkalojnë kohën shkrimore, japin shkas për ta parë dhe shijuar, si njëri nga lëvruesit e purolirikës në letrat shqipe. Pa mëtuar zgjidhjen përfundimtare, e cila kërkon kohë, trajtime dhe kontribute të gjera, për të patur një ide më të qartë të mënyrës së leximit të një poezie të Rreshpes, po paraqes leximin e një poezie, madje të situatës së pohuar nga H. Bloom, për leximin përmendësh, kur pohon:

*Një lexim i till*ë *ë*s*ht*ë *k*ë*rke*s*ë e ep*ë*rme, por nj*ë*koh*ë*sisht shp*ë*rblim i ep*ë*rm q*ë *vet*ë*m poezit*ë *ma t*ë *bukura mund ta falin*. (Bloom, 2008: 149). Anët e leximit të poezisë *Këngë lahute*:

Më zuri gjumi i balladave
Dalin etrit pleq në prag të rapsodive
Dhe natë e ditë një zog më rri te kryet.

O ti zogu i zi i amanetit,
Për ku vrapon të bësh shi, o zog?
Dy tre shira ranë e u bë dimër,
Dy tre netë u deshëm dhe u harruam.

Do të ngrihem e do të marrë dynjanë.

Por gjumi i balladave nuk më lë.

Dy tre shira ranë e u bë dimër,
Dy tre netë u deshëm dhe u grindëm.
(Rreshpja, 2018: 52)

Pamundësia e leximit tematik, ndonëse aty-këtu feksin ngjyra të erotikës, të peizazhit, të meditimit për lahutën, ndonëse atmosfera e vargjeve, në thelbin e vetë, skicon një çast vetmie dhe bota i vjen e rrëmujshme, në atë meditimin me veten.

Leximi i strukturës së vargjeve, ku paraqitet një çrregullësi e menduar ashtu. Në strofën e parë, tercina ndërtohet me vargun 11-rrokësh. Strofa e dytë, po me 11-rrokësh, vjen me kuatern, me strofë katërshe. Struktura shkërmoqet në stilemat me një varg, në dy raste, gjithnjë duke ruajtur vargun 11-rrokësh.

Leximi i detajave, lahuta në titull, ballada në vargun nistor dhe në vargun e tretë, duke numëruar nga fundi, që ndërlidh hapësirat e ligjërimit të poezisë, gojore dhe të kultivuar, të poezisë së këndume në Lahutë të Fishtës, të lahutës së Camajt, e mbetun vjerrë, që ndërlidhet me shpirtin e poetit, kthyem në lahutë, të mbytun në gjemitë e vetmisë.

Leximi i gjendjes letrare, i rrethanës specifike që përmend Italo Kalvino, që theksohet dy herë, të një situate të erotizmit të zjarrtë, madje me të njëjtën stilemë gjuhësore: *Dy tre netë u deshëm dhe u grindëm*.

Leximi si figurshmëri, ku veçohet prania e një simbolike të qartë, në vargun: *Dhe natë e ditë një zog më rri te kryet*, që në marrëdhënie me shiun dhe dimrin, ndërkaq sendërton mendimin e fshehtë, që përthekson vetminë e poetit, si dhe të metaforës grishëse: *O ti zogu i zi i amanetit*, që është korbi që të shpie në situata të befta.

Leximi tërësor i poezisë, që shqipton një metaforë të poetit-njeri, të unit të zhytur në jermi totale, që hedh në gërma grimcat e hidhësive, e ngjyrosjes së shnjgjyrosur të një realiteti absurd, gati jo real, që më tepër endet në kokën e poetit, madje në vetmi terri, që dëshmon shenjëzimet e lirikës së pastër, ku në mënyrë të veçantë, prania e pasthirmës dhe pyetjes retorike, e maksimalizojnë gjurmën e lirikës së pastër.

Hemisferat e pafundme të leximit të kësaj poezie, të bindin se tekstet e Rreshpes, në pjesën më të madhe janë me ngjyresa të rrokshme purolirike. Vargu është ama e gjurmës së poetit, tashmë i kthyer në melodi, ku shprehja është fryma e zërit, e prania e zërit vetmitar, është shenja unike e figurimit poetik. Në këto shenja të laryshisë lirike, duket dhe zhduket shpirti i poetit. Frederik Rreshpe, ka hy e ka me mbet në letërsi, prej poezisë, si dhe do të mbetet në poezi prej magjisë që përçon lirika, e sidomos lirika intime, e cila ndërkaq përfaqëson gjerdanin e lirikës së pastër. Vibratura e lirizmit të brishtë, të një poetike subtile, që ma tepër sendërgjon melodikën e brendshme, poezinë e shpirtit, rroken në gjithë librat e poetit, ndonëse farfurijnë në vargjet e secilës anë të fjalës poetike.

Literatura:

1 Rreshpe, Frederik: ***100 lirikat***, Albas, Tiranë 2018.
2 Clark, Ceneth: ***Qytetërimi***, Shtëpia e librit, Tiranë 2002.
3 Elioti, Tomas: ***Ese*** të zgjedhura, Rilindja, Prishtinë 1982.
4 Sopaj, Nehas: revista ***Stil***, Shkup, "Bomi", Shkup 1999.
5 Bremond, Henri: ***La poesie pure***, Bernard Grasset, Paris 1926.
6 Po, A. Edgar: ese ***Parimi poetik***, revista Stil, Shkup, "Bomi", Shkup 1999.
7 Bloom, Harold: ***Si dhe përse lexojm***ë, Botimet Dudaj, Tiranë 2008.

Impresione nga Berlini

Të kërkosh gjurmët e një rebeleje në Berlin

Nga Ana Kove

Cila grua do ketë bërë "të trandet" ky qytet? Legjendat urbane, por jo vetëm ato, thonë se është ndjellësja, rebelja, legjenda Marlene Dietrich. Ëndrra e të gjithë burrave në vitet

'30-të; natyrisht atyre që josheshin jo vetëm nga erotizmi i pamjes dhe zërit, por nga cilësitë e saj si grua e papërballueshme në liri, mençuri, bukuri dhe dashuri. *Femme fatale* tek "Engjëlli blu", frymëzimi verbues i Xhoan Madusë së "Harkut të Triumfit", aktorja e famshme e Hollivudit, balerina, këngëtarja; e dashuruara e përjetshme "nga maja e flokut te gisht i këmbës" është berlinezja më e famshme edhe sot e kësaj dite.

***

"Thuamë, ku janë lulet?"/"Sag mir wo die Blumen sind?" – Pyeti në këngë me zërin e saj drithërues. Ndjesitë e bukura lidhen me lulet; kur ngjyrat dhe aromat e tyre mungojnë, në shpirt s'ka lule, por dhimbje. Ai e takoi atë për herë të parë në qytetin e dashurisë dhe dhimbjes së madhe, në Venedig. Ata kishin mbi shpinë vitet e dashurive të shkuara, të martesave të tyre, famës, parasë, humbjeve. Aty mori jetë një ndjenjë tronditëse, por edhe e dhimbshme, dhe herë-herë dramatike. Ajo ishte një dashuri e madhe. Shumë e madhe. Ishte drama dhe ekstaza, ankthi, zemërimi dhe dëshira e madhe, gangrenë-vetëshkatërruese, dhe sërish çdo përpjekje e mundimshme t'u vetëharruar. Ajo ishte "Pantera e tij melankolike, zemra e butë, ëndrra që shndriste të gjitha pyjet, engjëlli blu, ylber i ëmbël para stuhisë së jetës, delfini në horizont, drita verbuese e veriut, flaka mbi dëborë.

"Të gjitha udhët më sjellin tek ti; dhe gjithkund të kërkoj'/ "Thuamë se më dashuron!?"/ 'Sag mir, dass Du mich liebst' – i shkroi Remarku asaj në më shumë se 300 letra.

***

Nuk paska ndjesi më identifikuese se dashuria; edhe post-mortum. Ajo i pranëvihet në kujtesën e brezave emrit dhe vendlindjes, që nuk zhduken as me zhdukjen e njeriut. Për Marlenën ishte dramatike dhe e dhimbshme edhe dashuria për vendlindjen. Berlini e lindi, e deshi, e dëboi; pastaj e përçmoi – dhe dikur e vlerësoi. Ajo e mbajti brengën e largimit, dhe të lëndimit për vete – pasi kështu mendonte - sepse: "Dhimbja është çështje tërësisht personale". "Unë e kam lënë një valixhe në Berlin"/"Ich habe einen Kofer in Berlin" - këndoi, dhe, kur malli dhe kujtimet i rrihin fort në gjoks si një zemër e dytë, fluturonte... jo gjithmonë me avionë, "dashuria fluturon me zogjtë". Sepse ajo dashuronte shume; dhe shume do të thotë "pa kushte". "Unë s'di të bëj gjë tjetër më mirë, vetëm se të dashuroj…"

***

Ja, edhe unë prej vitesh (për gjithë ç'kam lexuar dhe lexoj sërish) mbetem e joshur nga personaliteti artistik dhe njerëzor i Marlene Ditrich-ut, dhe gjithherë që vij, kërkoj gjurmët e saj nëpër Berlin: shtëpinë e lindjes, sheshin që mban emrin e saj, yllin me emrin e saj gdhendur në tokë para gjigantit Cine Star IMAX; në fund edhe varrin e saj. Ca njerëz ia vlen t'i njohësh edhe pas vdekjes...

KUR PËRKTHEJA KADARENË

PËRKTHIMI I POEZISË SI PJESË E BESIMIT LETRAR

Nga Mira Meksi

Sa herë flitet për poezinë dhe përkthimin e saj, pothuaj përherë thuhet se poezia bart një lloj dykuptimshmërie: është njëkohshëm universale dhe e papërkthyeshme. Universale, -- sepse shpirti njerëzor është i tillë, shpjegojnë, -- e papërkthyeshme sepse, me kalimin nga një gjuhë në një tjetër, me ndërrimin e shenjave grafike, ndryshon dhe muzika e saj, elementi thelbësor që ka. Por, përpara se të flitet për përkthim të poezisë, është e natyrshme të shtrohet pyetja e përjetshme: ç'është poezia? Si mund të përkufizohet me pak fjalë poezia? Me gjithë përpjektjet për ta shpjeguar, enigma mbetet. Benedetto Croce thote se poezia është një ndijim i brendshëm, një ngjarje intime në shpirtin e poetit. Ndërsa për Pessoa-n poet, poezia është një përshtypje e intelektualizuar, apo një ide e shndërruar në emocion, e cila u komunikohet të tjerëve, nëpërmjet një ritmi. Në librin e tij me ese "Harku dhe lira" Octavio Paz-i kuturiset e bredhërin lëmit poetik duke u rrekur të japë një përgjigje për pyetjen në fjalë. Me anë të një ligjërimi poetik, bën një përpjekje për të përcaktuar të papërcaktueshmen poezi dhe për të arritur te poezia nëpërmjet vetë poezisë; interesante është të thuhet se një nga instrumentat që ai përdor për të hedhur pakëz dritë brenda labirintit të mjegullt të temës në fjalë, pra, për ta shpjeguar poezinë, është perspektiva e përkthimit të poezisë, e cila përfshihet në atë që cilësohet "përvojë e poezisë" dhe që me fjalë të tjera është rikrijimi i saj...

Po le t'i kthehemi përkthimit të poezisë: është, padyshim një proces i ndërlikuar dhe shumëfaqësh, po të mendohet, përpos të tjerash, se poezia e përdor "fjalën" si një instrument artistik, shpesh jashtë shtratit të saj kuptimor; aq e vështirë është t'ia dalësh e ta përkthesh besnikërisht një "huq" të tillë të poezisë, sa shprehja "Traduttore, traditore" duket se është shpikur pikërisht për përkthyesit e poezisë. Ka zëra që thonë se përkthimi i poezisë, përkthimi i emocionit njerëzor, është një ndërmarrje pothuaj e pamundur, se përkthyesi është i destinuar të dështojë në përkthimin e poezisë, madje, ata arrijnë gjer aty sa ta mohojnë krejtësisht përkthimin poetik; por ka të tjera zëra që thonë se përkthimi poetik pasuron, se e kthen të ndryshmen në të ngjashme, madje, edhe kur nuk e arrin dot këtë, të paktën na sjell në shtëpi atë gjënë e ndryshme që përfaqëson origjinali. Sa për poezinë si shprehje e emocioneve njerëzore, këto zëra thonë se emocionet njerëzore janë, në pjesën më të madhe të tyre, të ngjashme dhe se mund të shprehen në çfarëdolloj gjuhe. Përkthyesi i poezisë duhet të rreket të gjejë kalket përgjegjëse, të afta që të ngjallin emocione të ngjashme te lexuesi. Në fund të fundit, atë që mund të cilësohet si "efekt i kërkuar", nëse do të shpreheshim me gjuhën e Walter Benjamin-it, kur në "Misioni i përkthimit" pohon se " të përkthesh do të thotë të dish të përcjellësh atë çka në një tekst shfaqet si efekt i kërkuar".

Borges-i është në një mendje me ata që shprehen se "çdo gjuhë ka mundësitë dhe pamundësitë e veta", por nuk e pranon përfundimin se përkthyesi letrar është i dënuar të dështojë. Përkundrazi, Borges-i pohon se ndryshimet mes gjuhëve dhe mënyrat e ndryshme të shprehjeve i japin një përkthyesi, që ka për mjeshtëri rikrijimin nga origjinali, mundësi të shumëllojta. Për Borges-in përkthyesi përherë duhet të përdorë lirinë e nevojshme për të arritur atë që çdo shkrimtar kërkon: një vepër letrare bindëse. Përkthimi i poezisë, ndonëse është përherë një sfidë e madhe për përkthyesin, ka njohur arritje të tilla, kur varianti i përkthyer është konsideruar si i të njëjtit nivel me origjinalin: në krye të kësaj liste janë përkthimet në frëngjisht që Baudelaire-i u ka bërë poezive të Edgar Poe-së. Apo përkthimi nga Pessoa në portugalisht i poezive të Poe-s "Annabel Lee" dhe "Ulalume"; "Poezi që i përktheva jo për hir të vetë vlerave që bartin, por sepse paraqiteshin si një sfidë e vërtetë përpara përkthyesve", na thotë përkthyesi.

M'u desh të rendis gjithë sa më sipër për të rrëfyer se në ç'univers të koklavitur e të vështirë u gjenda viteve 1987-88, kur nisa të përktheja në frëngjisht poezitë e Kadaresë, të cilat përmblidhnin rreth tridhjetë vjet krijimtari të autorit; në të vërtetë, e kisha filluar përkthimin e tyre shumë më parë se të më besoheshin "zyrtarisht" prej tij, në kohën kur studioja për filologji frënge. Ishte koha kur besoja në fatin tim prej përkthyeseje letrare, kur dija përmendësh qindra vargje të poetëve klasikë dhe modernë francezë, kur përpiqesha të përktheja në frëngjisht poezi të Nolit dhe të profesorit tim të përkthimit Vedat Kokonës, dhe kur shkruaja vetë vargje në frëngjisht (në të vetmen gjuhë që kam guxuar të shkruaj vargje ndonjëherë), të cilat kishin për lexues vetëm pedagogët e mi francezë dhe shokët e kursit.

Që në krye të herës, ndonëse e kisha të qartë se përkthimi nga shqipja në frëngjisht ishte ku e ku më i vështirë se nga frëngjishtja në shqip, mbaj mend, pata krijuar bindjen se, ndryshe nga besimi i përgjithshëm se përkthimi ishte një "poezidëmtues" a "poezivrasës", përkthimi në vetvete ishte element përbërës i poezisë dhe se poezia lindte dhe gjallonte nëpërmjet tij: poeti kur shkruan poezinë s'bën gjë tjetër veçse "përkthen" emocionet e tij në gjuhën e fjalëve, ndërsa lexuesi bën të kundërtën, "përkthen" fjalët e poezisë në emocione. Madje, ai bën një "përkthim" të dyfishtë: emocionet e përftuara duhet t'i "përkthejë" në kodin, a gjuhën e emocioneve të tij.

Me këtë mendim dashamirës e të ngrohtë për marrëdhënien poezi-përkthim mora në sy sfidën e madhe të përkthimit në frëngjisht të poezive të Kadaresë. Isha, në fund të fundit, një lexues i veçantë i cili, gjuhën e emocioneve që kish arritur të vilte nga poezia e Kadaresë, do t'ia përcillte të ngjashmit të vet francez. Kishte poezi të krijuara përpara se të lindja unë dhe në vise të largëta (mësova që, për t'i përjetuar, t'i klasifikoja në kohët e jetës sime): valë brigjeve të Jaltës, gjire të Rigës, re që mërgonin drejt Suedisë, gra ëndërrore me emrin Birgit, kujtime që ktheheshin në statuja, tunele që nisnin në stacionin Arbatskaia dhe që gëlltisnin njerëzit si gojët e Harresës, dhe Lora... klima e tyre ishte e jashtëzakonshme dhe përjetimi i tyre prej meje, ishte si përjetimi i një jete që e kisha

jetuar domosdo, por që më ishte fshirë nga kujtesa -- rigjetja e saj më dha shijen e një identiteti të thellë. Pastaj vinin poezi që ishin krijuar aty nga viti i parë i lindjes sime dhe më pas në fëmijërinë time të hershme: tramvaje të pasmesnatës nëpër vende të huaja, orë të ndarjes, gishtërinj malli, të gjatë me kilometra që pleksen flokëve të dashur me gishtërinj të tjerë të huaj, qiej dimri, me një finlandeze në bar, vjeshta që mbron si luan ditët e saj të fundit nga dimri, aeroporti i Rinasit, Luvri, orare trenash.... Pastaj beteja e fushë Kosovës më 1389 dhe gjëma e ballkanasve, dhe alfabetëve të përgjakur, gjuhë të vdekura, marshi i akullnajës, teknika dhe poezia, fusha të dimërta, Sahara dhe drerë qiellorë që përndiqen nga qentë përballë mospërfilljes së yjeve...

Poezia e Kadaresë kishte gjithçka: mendim, ide dhe kumte, mister, simbole, emocion, ritëm fjalësh dhe ritëm imazhor, muzikë, -- një klimë e tërë estetike, e cila duhej transplantuar në një tjetër klimë estetike. Kishte poezi ku mendimi apo ideja e Kadaresë duhej transmetuar në frëngjisht me një besnikëri të madhe dhe përpara të gjithave, por, duhej ruajtur me çdo kusht bukuria e të shprehurit. Siç thashë më lart, Pessoa e barazon poezinë me ritmin që ka; ai shprehet: "Ky ritëm është i dyfishtë, njëlloj si anët konkave dhe konvekse të një harku: përbëhet nga një ritëm fjalësh apo muzike dhe një ritëm pamor apo imazhor, të cilët veprojnë në brendësinë e tij. Andaj, përkthimi i një poezie duhet t'i përshtatet absolutisht, e para, idesë apo emocionit që përbëjnë poezinë, dhe e dyta ritmit verbal në të cilin kjo ide apo ky emocion shprehet". "Ajo pjesë e poezisë që godet syrin e imagjinatës së lexuesit nuk ka për të humbur asgjë nga përkthimi në një gjuhë të huaj; ajo që i bën thirrje dëgjimit arrihet vetëm në origjinal" thotë Ezra Pound.

Kishte poezi që mbanin, për hir të rrethanave dhe kohës kur ishin shkruar, një kumt të fshehtë dhe mbeta shpesh në mëdyshjen: Ta bëja më të qartë kumtin për lexuesin francez? A do të arrinte ai vallë ta zbulonte vetë si lexuesi shqiptar, i rregjur në zbulimin e kumteve të fshehta të Kadaresë? Një tjetër vështirësi shfaqej përpara meje: dhënia e pikës së saktë të misterit që mbarte një pjesë e poezive, -- as duhej ta rrisja atë, dhe as duhej ta zbardhja. Thuhet se përkthyesi, njëlloj si aktori apo violinisti, vendoset në mes të krijuesit origjinal, autorit, dhe të lexuesit, apo pritësit. Roli i tij është t'i komunikojë këtij të fundit nëpërmjet gjuhës, me sa më pak ndryshime që të jetë e mundur, mesazhin dhe çastin estetik të krijuesit . Duhet të veprojë në mënyrë të tillë që të meritojë titullin e një krijuesi të vërtetë të Artit dhe jo të shërbejë vetëm si një urë. Pra, realisht, më duhej të deshifroja fjalët-simbole të përdorura nga Kadareja për të shprehur mendimet, idetë, kumtet, misteret e tij, të përjetoja dhe të bashkëndaja me të përvojat e tij mistike dhe pastaj të gjeja fjalët e mia-simbole, me anë të të cilave do t'i jepja lexuesit francez mesazhin e Kadaresë, me një ngarkesë estetike sa më afër origjinalit. Dhe kulmi fare, duhet të sillesha vërtet si krijuese, por duhet të isha vetëm çelësi në dorë të lexuesit, i cili ftohej të hynte në botën e brendshme të autorit; pra, duhet të rrija veç në prag të asaj bote dhe krejt neutrale.

Ishte shumë e vështirë dhe pothuaj e rrezikshme: gjer në ç'masë isha e lirë në artin tim të përkthimit? Gjer në ç'shkallë duhet të isha e përgjegjshme, domethënë gjer në ç'shkallë duhet të isha "e drejtë, e saktë" ndaj autorit? Po ndaj lexuesit? çfarë elementesh të poezisë duhet të sakrifikoja në të mirë të elementëve të tjerë? Sepse pa dyshim "sakrifikime" do të kishte, kur përpara meje ngrihej barriera e rreptë e gjuhës. Nuk kishte rregulla absolute, madje, s'kishte fare rregulla; përgjegjësia dhe liria më shqetësonin shpirtin dhe më turbullonin punën e çdo dite. Duhej vendosur një ekuilibër mes të dyjave, por s'qe aspak e lehtë, përkundrazi, u torturova gjatë mes dyshimeve të gjembëta.

Bëri punë vetëm magjia e poezisë. Isha aq e kredhur në universin e poezisë, aq e mbushur me të, dhe aq shumë jetoja për të, sa dikur ndjeva se isha e "pushtuar" prej saj, gjer në atë pikë sa më ngjante se vargjet që përktheja në frëngjisht, në të vërtet dilnin prej meje që në burim, krijoheshin nga unë, sikur unë të isha vetë autori; ishte një iluzion shpëtimtar që vendosi ekuilibrin e duhur mes përgjegjësisë dhe lirisë së zejes sime: bëri që zëri poetik përkthimor të ish shumë pranë origjinalit. Kisha hedhur mbi supe një fat përunjësie dhe nënshtrimi ndaj produktit të autorit, kisha lënë gjer identitetin tim krijues, kisha përqafuar identitetin krijues të autorit dhe metoda e punës doli të ishte krejt origjinale: i mësoja përmendësh poezitë në shqip, nga leximi i shumëhertë dhe me muzikën dhe mesazhin e tyre në mendje, pastaj, vargjet dilnin vetiu në frëngjisht, edhe në çastet më të pamendueshme të jetës sime: edhe në gjumë. Kishte raste kur lidhësat, përemrat, ndonjë formë foljore hidheshin në erë nga "natyrshmëria" e lindjes së vargjeve në gjuhën frënge, çka prodhonte edhe ndonjë gabim gjuhësor "të detyruar", që Claude Durand-i redaktonte më pas me kujdes.

Në esenë e tij "Mjeshtëria e besimit letrar" Borges-i flet për krijimin letrar si për një besim të veçantë: " ... për *credon* time letrare mund të pohoj pjesën që ka të bëjë me religjionin: është imja përderisa besoj në të, jo ngase e kam shpikur unë…" Dhe "*credo*"-ja ime asokohe ishte, pa dyshim, besimi pothuaj religjoz, fetaria ime ndaj realitetit të poezisë dhe përkthimit të saj: ishte i njëjti realitet që ndante autori dhe unë. Dhe i njëjti besim, sigurisht.

Kadareja vinte në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori", ku punoja asokohe, me një bllok të numërtuar rreptë ku mbante poezitë që shkruante, shumica të pabotuara, dhe nga ku më jepte syresh në formën e dorëshkrimit për t'i përkthyer. Në fletët e atij blloku ndodhej edhe poezia *Sapuni "Ledi Makbeth"*, e porsashkruar (viti 1987), cila, poshtë titullit kishte fjalën "Antireklamë"... Më goditi përnjëherë: mesazhi i saj ishte i tmerrshëm, tronditës, rrëqethës: sapunin gjakshlyes njerëzimi nuk kishte për ta shpikur asnjëherë, kjo ishte gjëja më e çmuar e tij, krimet nuk shlyheshin kurrë, madje edhe pas katërqind vjetësh... E përktheva poezinë me një ndjenjë të fuqishme të dyfishtë: e magjepsur nga forca e së vërtetës së saj dhe e frikësuar për vdekje për fatin tim dhe për fatin e autorit, -- ishim mësuar që "Ledi Makbeth" të quanim nën zë Nexhmije Hoxhën, aludimi ishte fare i qartë, në dritë të diellit, dhe asokohe, vejusha e diktatorit ishte më e fuqishme dhe më e rrezikshme se kurrë. U mata me dhjetëra herë të flisja me Kadarenë e t'i komentoja se, ndonëse poezia nuk do të botohej në Shqipëri, por do të shkonte e do të botohej frëngjisht drejt e në Francë, ai ishte në rrezik të madh (nuk do t'ia përmendja fare frikën që kisha edhe për vete). Por natyrshmëria me të cilën ma dha poezinë e frikshme dhe një lloj moskokëçarje e çuditshme apo një lloj "guximi" naiv, më penguan ta bëja: nuk mori mundimin as të më paralajmëronte që të mos ia rrëfeja kujt dorëshkrimin e poezisë.

E kam vrarë mendjen gjatë kohë më pas se si ndodhi që Kadareja më besoi aq lehtësisht poezinë e rrezikshme.Vite më vonë e pyeta dhe nuk dinte të më përgjigjej, por unë isha tashmë e sigurt: i ishim dorëzuar dhe i përkisnim tërësisht Besimit të përbashkët të krijimit letrar, *Credos* së Borges-it, i cili bëri të mbeteshim gjallë kohëve të liga që jetuam dhe ruajti nga prishja pjesën tonë më të qenësishme, shpirtin tonë.

18 Shtator 2010

Gjer më 1948-ën Ionesco kishte shkruar disa ese, pak poezi dhe ndonjë artikull, ku spikatnin tashmë dukshëm përjetesat e absurdit. Mirëpo, kur vendos t'i hyjë mësimit të anglishtes, me metodën Assimil, i shkrep mendimi i një pjese, ku brofin fjali mekanike të një doracaku bisedimor. Këtu zë fill universi i pjesëve të tij aq të arrira, duke nisur me "Këngëtarja tullace", ku këmbimi në erë e rrakapjekthi i fjalëve që s'ta mbushin syrin shndërrohen në pikënisje të një padie të hatashme ndaj pakuptueshmërisë dhe cektësisë së marrëdhënieve njerëzore.

EUGÈNE IONESCO
TRAGJEDIA E LIGJËRIMIT

Më 1948-ën, para se të shkruaja pjesën time të parë "Këngëtarja tullace", nuk ma kishte fort ënda të bëhesha dramaturg. Thjesht, kisha vetëm ambicjen të mësoja anglisht. Mësuarja e anglishtes nuk të çon medoemos te dramaturgjia. Përkundrazi, ngaqë nuk ia dola dot mbanë të mësoja anglishten, pa u bëra shkrimtar pjesësh teatrore. Nuk është se këto pjesë i shkrova si për t'u hakmarrë ndaj dështimit tim, megjithëse është thënë që "Këngëtarja tullace" përbënte një satirë të kulluar ndaj borgjezisë angleze. Po të më kishte shkrepur në kokë dhe të mos ia kisha dalë dot mbanë të mësoja italishten, rusishten a turqishten, do të thuhej po kaq ashiqare se pjesa ishte rrjedhojë e kësaj përçapjeje të kotë, përbënte një satirë të hatashme për shoqërinë italiane, ruse a turke. E ndjej se duhet të jap shpjegime më imtësore. Ja se çfarë ngjau: pra, për t'i hyrë anglishtes, bleva këtu e nëntë a dhjetë vjetë të shkuara, një doracak bashkëbisedimesh franko - angleze, për përdorim nga fillestarët. Iu futa punës. Me vetëdije të plotë, për t'i mësuar përmendsh, kopjoja fjali të tëra, të shkëputura nga librushka. Duke i rilexuar me shumë vëmendje, do ti që nisa të mësoja, jo anglishten, por disa të vërteta befasonjëse: kështu, bie fjala, java paskësh shtatë ditë, gjë që gjithsesi e dija, ose ta zëmë që dyeshemeja ndodhet poshtë, kurse tavani lart, gjë që e dija po ashtu, ndoshta, por, për të cilën nuk e kisha vrarë kurrë mendjen aq seriozisht a që mund ta kisha harruar fare dhe që, befas, po më shfaqej sa habitshëm, aq edhe padiskutueshmërisht e njëmendtë. Pa dyshim, që unë e kam aq ftillim filozofik, sa ta pikas që nuk po rishkruaja në fletorkën time vetëm disa fjali thjeshtake angleze, të përkthyera në frëngjisht, por disa vërtetësi themelore, konstatime të thella.

Megjithatë, ende nuk hoqa dorë nga anglishtja. Për fat të mirë sepse, pas të vërtetave universale, autori i doracakut më zbulonte edhe disa të vërteta të veçanta, dhe për t'ia dalë mbanë, ky autor, i frymëzuar, padyshim, nga metoda platonike, i shprehte ato me anë të dialogut. Qysh nga mësimi i tretë spikat prania e dy personazheve, të cilët sot e kësaj dite nuk e di, nëse qenë të vërtetë a të sajuar: Z. dhe Znj. Smith, një çift anglez. Si për të më mrekulluar të gjithin sa s'thuhet, Zonja Smith i bënte të ditur të shoqit, se ata kishin shumë fëmijë, se banonin në rrethinat e Londrës, se mbiemrin e kishin Smith, se Zoti Smith ishte zyrtar, se kishin një shërbyese, Mary-n, po ashtu angleze, se që prej njëzet vjetësh kishin miq që quheshin Martin, se shtëpia e tyre ishte një pallat ngaqë "shtëpia e një anglezi përbën pallatin e tij të vërtetë".

Po thosha pak më sipër që Zoti Smith duhej të ishte disi në dijeni për gjithë këtë. Mirëpo, ku i dihet, ndonjëherë ka edhe njerëz tejet të hutuar. Nga ana tjetër, bëjmë mirë t'u kujtojmë të ngjashmëve tanë gjëra që mund t'i harrojnë a për të cilat nuk janë edhe aq të vetëdijshëm. Përtej këtyre vërtetësive të veçanta, gjithëkohore ishin edhe disa të vërteta të tjera çastore, që shfaqeshin qartas: bie fjala, që Smith-ët sapo kishin ngrënë darkë dhe që ishte ora nëntë e mbrëmjes, me orën angleze, sipas sahatit me lavjerrës.

Më lejoni t'ju tërheq vëmendjen rreth karakterit të padyshueshëm, përsosmërisht aksiomatik të pohimeve të zonjës Smith, si dhe rreth përçapjes kryekëput karteziane të përpiluesit të doracakut tim të anglishtes, sepse ajo që shquante në të ishte përparimi sipëror metodik i kërkimit të së vërtetës. Në mësimin e pestë ia behnin Martin-ët, miqtë e Smith-ve. Ndizej bashkëbisedimi mes të katërve dhe, përmbi aksiomat fillestare ngriheshin të vërteta më plotësore: "fshati është më i qetë se qyteti i stërmadh", pohonin disa, "po, por në qytet popullsia është më e dendur ama, ka më shumë shitore", ia prisnin të tjerët, çka është mëse e vërtetë dhe dëshmon, për më tepër, që vërtetësitë kundërshtore mund të bashkëjetojnë për bukuri.

Sakaq, më shkrepi befas një mendim. Për mua nuk bëhej më fjalë të përsosja njohjen e gjuhës



angleze. Të jepesha pas pasurimit të fjalorit tim në anglisht, të mësoja fjalë për të përkthyer në një gjuhë tjetër, atë çka mund ta shprehja bukur fort në frëngjisht, pa marrë parasysh "përmbajtjen" e këtyre fjalëve, se ç'kumtonin ato, do të ishte njëlloj si të bije në mëkatin e formalizmit, të cilin sot diturakët e mendimit e dënojnë me plotë të drejtë. Ambicja ime kishte marrë përmasa më të mëdha: t'u përcillja bashkëkohësve të mi të vërtetat thelbësore, që më kishte sjellë ndërmend doracaku i bashkëbisedimeve franko-angleze. Nga ana tjetër, dialogjet e Smith-ve, Martin-ve, e Smith-ve dhe Martin-ve, ishin mirëfilli teatër, meqë teatri është dialog. Më duhej, pra, të shkruaja pikërisht një pjesë teatrore. Dhe shkrova, kështu, "Këngëtarja tullace" e cila është një pjesë teatrore kryekëput didaktike. Po përse kjo vepër quhet "Këngëtarja tullace" e jo, bie fjala, "Anglishtja pa mundim", siç më shkrepi ta emërtoja së pari, as "Ora angleze", siç ma pat ënda ta quaja një çast më pas? Ha gjatë, po t'i vihesh ta shkoqitësh: njëra nga arsyet për të cilat "Këngëtarja tullace" u emërtua kështu, qëndron në faktin që aty nuk shfaqet asnjë këngëtare, tullace a ma flokë qoftë. Ky detaj duhej të mjaftonte. Një pjesë e mirë e veprës përbëhet nga vënia kokë më kokë e fjalëve të nxjerra prej libërthit të anglishtes. Smith-ët dhe Martin-ët e të njëjtit doracak janë Smith-ët dhe Martin-ët e pjesës sime. Janë po ata, shqiptojnë të njëjtat thënie, bëjnë të njëjtat veprime a të njëjtat "joveprime". Në çdo "teatër didaktik" nuk të mbetet të jesh origjinal, as të thuash atë që mendon vetë: kjo gjë do të përbënte një gabim të rëndë kundër "të vërtetës" objektive. Nuk na mbetet veç të përcjellim, urtësisht, vetë mësimin që na ishte përçuar, idetë që na ishin ngulitur. E si mund t'i lejoja vetes t'u ndryshoja gjënë më vocërrake atyre fjalëve që shprehnin në mënyrë kaq të përkorë të vërtetën absolute? Duke qenë "autentikisht" didaktike, pjesa ime, nuk duhej të ishte kurrsesi, sidomos origjinale, pa le shpërfaqëse e talentit tim!

...Megjithatë, teksti i "Këngëtares tullace", qe mësim (dhe kopjim) vetëm në fillim. Nuk di ta them se si ngjau një dukuri mjaftë e çuditshme: krejt pa u ndjerë, teksti u shndërrua në sytë e mi, përtej çdo dëshire nga ana ime. Fjalitë tejet të thjeshta e regëtuese, që pata mbajtur shënim me aq ëndje në fletorkën time, të braktisura aty, pas njëfarë kohe, sikur u tjetërsuan, lëvizën vetiu, u shkapërdrodhën, u shpërfytyruan. Fjalitë bisedimore të doracakut të cilat, gjithsesi, i pata kopjuar me mjaftë saktësi e në mënyrë aq sqimatare, u çakërdisën njëra pas tjetrës. Po kështu, e pësoi edhe kjo e vërtetë e pamohueshme, mëse e sigurt: "dyshemeja ndodhet poshtë, tavani është lart". Pohimi - po aq i prerë, sa edhe i qëndrueshëm: shtatë ditët e javës janë, e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte, e premte, e shtunë, e dielë - u zhbë dhe Z. Smith, heroi im, këmbëngulte se java u përbëkësh nga tri ditë, të cilat qënkeshin: e marta, e enjtja dhe e marta. Personazhet, borgjezët e mi çapkënë, Martin-ët, burrë e grua, i goditi sëmundja e amnezisë: edhe pse shiheshin e flisnin çdo ditë me shoshoqin, ata nuk e njohën dot më njëri-tjetrin. Ndodhën edhe gjëra të tjera llahtarisëse: Smith-ët na vunë në dijeni për vdekjen e njëfarë Bobby Watson, që nuk kish Zot ta identifikonte, sepse ata na vinin po ashtu në dijeni që tre të katërtat e banorëve të qytetit, burra, gra, fëmijë, maçokë e ideologë mbanin emrin Bobby Watson. Një personazh i pestë i papritur ia beh, më në fund, për të theksuar turbullirën ë dergjjeve paqtore, kapiteni i zjarrfikësve, i cili tregonte rrëfenja në të cilat, me ç'dukej, bëhej fjalë për një dem riosh që mund të kishte pjellë një vemje të stërmadhe,

për një mi të mbarsur që mund të pillte një mal. Mandej, zjarrfikësi ikte që të mos i shkonte huq një zjarr i cili duhej të binte në anën tjetër të qytetit, i paralajmëruar qysh prej tri ditësh, shënuar në bllokun e tij të xhepit. Ndërkohë, Smith-ët dhe Martin-ët po nisnin sërish bashkëbisedimin. Ta hajë dreqi! Të vërtetat e mirëfillta dhe diturake që shkëmbenin, të kokolepsura njëra pas tjetrës, qenë çmendur plotësisht. Ligjërimi kishte lajthitur. Personazhet ishin shpërbërë. Fjala, absurde, qe zbrazur e s'i kishte mbetur më përmbajtje. Gjithçka përfundonte në një grindje, që vështirë se mund t'ia merrje vesh shtysat, ngaqë heronjtë e mi nuk ia ngjishnin shoshoqit në surrat me fjali a copëza fjalish, as me fjalë, por ose me rrokje, ose me bashkëtingëllore a zanore...!

...Për mendimin tim, duhej të kishte ngjarë ndonjë shkrehje e reales. Fjalët qenë shndërruar në lëvozhga tingullore pa pikë kuptimi. Afërmendsh që edhe personazhet qenë zbrazur nga psikologjia dhe bota më shfaqej në një zbardhëllimë të pazakontë, ndoshta me dritën e saj të njimendtë, përtej interpretimeve e ndonjë shkakësie arbitrare.

Duke shkruar këtë pjesë (sepse kjo qe shndërruar në një lloj pjese a anti - pjesë, domethënë një parodi e vërtetë pjese, një komedi komedie), më kishte mbërthyer një angushti e njëmendtë, marramendje, neveri. Hera-herës isha i detyruar të ndërprisja punën dhe duke i bërë pyetjen vetes se ç'dreqin më shtynte të vazhdoja të shkruaja, shkoja e shtrihesha në kanape me frikë se mos shembesha tok me të në zbrazëtirë. Kur e përfundova, ama, këtë punë, e ndjeva veten shumë krenar. Përfytyroja që kisha shkruar diçka si "tragjedia e ligjërimit"!

Kur u vu në skenë, unë thuajse habitesha, tek dëgjoja të qeshurat e spektatorëve që e morën (dhe vazhdojnë ta marrin) këtë gjë gëzueshëm, duke e mbajtur gjithçka për komedi. Disa nuk u gabuan (në mes tyre Jean Pouillon-i), teksa e ndjenë angushtinë. Madje disa të tjerë pikasën se aty vihej në lojë teatri i Bernstein-it dhe aktorët e tij. Komedianët e Nicolas Baille-it e kishin vënë re këtë gjë qyshkur, teksa e luanin pjesën (sidomos në shfaqjet e para) porsi melodramë.

Më pas, duke e zbërthyer veprën, disa kritikë seriozë e diturakë e interpretuan vetëm si kritikë ndaj shoqërisë borgjeze dhe si parodi të teatrit të Boulevard-it. Sapo thashë që edhe unë e tumir këtë interpretim: megjithatë, në mendjen time nuk bëhet fjalë për satirizim të mendësisë mikroborgjeze në lidhje me këtë apo atë shoqëri. Në të, bëhet fjalë, sidomos, për njëfarë mikroborgjezie universale, meqë mikroborgjezi është njeri i mendimeve kallëp, i sllloganeve, konformist i kudogjindshëm: këtë konformizëm, sigurisht, e ngërthen "ligjërimi i tij automatik". Teksti i "Këngëtares tullace", a i doracakut për të mësuar anglisht (rusisht a portugalisht), i përbërë nga shprehje të ngurta, klishera nga më pataksëset, po më zbulonte dora-dorës shtampat e ligjërimit, të sjelljes së njerëzve, "të folurën për të mos thënë kurrgjë", të folurën ngaqë s'të ka mbetur gjë vetjake për të thënë, mungesën e jetës shpirtërore, mekanikën e përditshmërisë, njeriun që dremit në mjedisin e vet shoqëror, pa e bërë fare qejfin qeder: Smith-ët, Martin-ët nuk dinë më të flasin, sepse ata nuk dinë më të mendojnë. Ata nuk dinë më të mendojnë, sepse nuk dinë më të emocionohen, nuk kanë më pasione, nuk dinë më të jenë, ata mundin "të shndërrohen" në tjetërkënd, në shumëçka, sepse duke mos qenë vetja, janë thjesht të tjerët, bota e jovetjakësise, ata jane vetëm të ndërkëmbyeshëm: mund të vendoset Martin-i në vend të Smith-it e anasjelltas,pa rënë në sy kurgjë. Personazhi tragjik nuk ndryshon lehtë, por thyhet. Ai është vetvetja, është real. Personazhet komike janë njerëz që nuk ekzistojnë...

Përktheu nga frëngjishtja LUAN CANAJ

ANDREAS DUSHI

Marrja e gjakut

OnufriRoman